

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projekt-ligj "Për Inteligjencën Artificiale"
MINISTRIA UDHËHEQËSE	AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (autoritet zbatues dhe koordinues teknik)
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim publik (drafti është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike – RENJK, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 'Për njoftimin dhe konsultimin publik')
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Nismë e Këshillit të Ministrave, e mbështetur në angazhimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) për përafrimin progresiv të legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti me kuadrin e ri rregullator të BE-së për teknologjitë dixhitale
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Regullorja (BE) 2024/1689 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 qershor 2024, që përcakton rregulla të harmonizuara për inteligjencën artificiale (Akti i BE-së për Inteligjencën Artificiale – "EU AI Act")
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	(i) Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, kapitulli i negociimit nr. 10 'Shoqëria e informacionit dhe media' dhe kapitulli nr. 28 'Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit'; (ii) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022-2030, shtylla e qeverisjes dixhitale dhe inovacionit; (iii) Strategjia Ndërsektorale për Axhendën Dixhitale të Shqipërisë 2022-2026 dhe Plani i saj i Veprimit, që parashikon shprehimisht hartimin e kuadrit ligjor kombëtar për IA-në si masë prioritare; (iv) Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025; (v) Programi i Qeverisë 2021-2025, kapitulli 'Shqipëria Dixhitale'.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	29.05.2026-26.06.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	

A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo, raporti është në fazën e konsultimit publik dhe ende nuk i është paraqitur Kryeministrit për shqyrtim përfundimtar.
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 –AKSHI – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Insidor Rexhepi Insidor.rexhepi@akshi.gov.al +355 69 292 2188 Fiorela Sina fiorela.sina@akshi.gov.al +355 69 209 213
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	
<p>Zhvillimi i shpejtë i teknologjive të inteligjencës artificiale po sjell transformime të rëndësishme në mënyrën e funksionimit të ekonomisë, administratës publike dhe ofrimit të shërbimeve në Shqipëri, duke krijuar mundësi të reja për efikasitet, inovacion dhe përmirësim të vendimmarrjes. Megjithatë, ky zhvillim po ndodh në një kontekst ku mungon një kuadër i posaçëm ligjor dhe institucional që të rregullojë në mënyrë të plotë dhe të unifikuar zhvillimin, vendosjen në treg, përdorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të inteligjencës artificiale.</p> <p>Në mungesë të një rregullimi të tillë, kuadri ekzistues ligjor mbetet i fragmentuar dhe mbështetet në dispozita të përgjithshme që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, konsumatorin, sigurinë kibernetike dhe sigurinë e produkteve. Këto rregulla, megjithëse të rëndësishme, nuk arrijnë të adresojnë specifikat dhe rreziqet e veçanta të sistemeve të IA-së, veçanërisht në lidhje me transparencën, mbikëqyrjen njerëzore, menaxhimin e riskut dhe vlerësimin e konformitetit.</p> <p>Ky boshllëk shoqërohet me disa pasoja të ndërlydhura. Së pari, ekziston rreziku që përdorimi i sistemeve të IA-së të cenohet të drejtat themelore të qytetarëve, përfshirë privatësinë, mosdiskriminimin dhe aksesin e barabartë në shërbime, sidomos në fusha si punësimi, kreditimi, arsimit dhe administrata publike, ku vendimmarrja e automatizuar mund të prodhojë rezultate të padrejta ose jo transparente. Së dyti, sistemet me rrezik të lartë mund të përdoren pa standarde të mjaftueshme sigurie dhe kontrolli, për shkak të mungesës së detyrimeve për testim, dokumentim teknik dhe monitorim të vazhdueshëm gjatë ciklit të jetës së tyre. Së treti, operatorët ekonomikë përballen me pasiguri juridike, pasi nuk kanë një kuadër të qartë mbi detyrimet e tyre, ndërkohë që mungesa e harmonizimit me rregulloren evropiane krijon edhe pengesa për aksesin në tregun e BE-së dhe rrit kostot e pajtueshmërisë.</p> <p>Shkaqet e këtij problemi lidhen kryesisht me mungesën e një ligji të dedikuar për inteligjencën artificiale, ndërsa legjislacioni ekzistues është i fragmentuar në disa fusha sektoriale dhe nuk arrin të krijojë një qasje të unifikuar rregullatore. Kjo fragmentim shoqërohet gjithashtu me mungesën e përafërimit të plotë me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë, si dhe me kapacitete të kufizuara institucionale për të mbikëqyrur dhe vlerësuar sistemet komplekse të IA-së. Për më tepër, vetë natyra teknike e këtyre sistemeve – përfshirë kompleksitetin, mungesën e transparencës (“black box”), aftësinë për t’u përshtatur dhe varësinë nga të dhënat – e bën edhe më të vështirë rregullimin efektiv në mungesë të një kuadri të posaçëm.</p> <p>Grupet më të prekura nga ky problem janë qytetarët, të cilët mund të ndikohen drejtpërdrejt nga vendime të automatizuara në fusha thelbësore të jetës së tyre, si dhe operatorët ekonomikë vendas,</p>	

veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe start-up-et që zhvillojnë ose përdorin sisteme IA pa një kornizë të qartë rregullatore. Po ashtu, preken institucionet publike, të cilat po rrisin përdorimin e IA-së në ofrimin e shërbimeve dhe proceset vendimmarrëse, por pa instrumente të mjaftueshme mbikëqyrjeje dhe kontrolli. Në mënyrë të ngjashme ndikohen edhe ofruesit e huaj të teknologjive të IA-së që synojnë tregun shqiptar, si dhe vetë administrata shtetërore, e cila duhet të ndërtojë kapacitete të reja institucionale për rregullim dhe mbikëqyrje efektive.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivi i përgjithshëm i politikës është: 'Krijimi i një kuadri ligjor kombëtar gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar me Rregulloren (BE) 2024/1689 (EU AI Act), që garanton mbrojtje efektive të shëndetit, sigurisë, të drejtave themelore, demokracisë dhe shtetit të së drejtës nga rreziqet e sistemeve të inteligjencës artificiale, dhe njëkohësisht krijon kushte mbështetëse për zhvillimin dhe përdorimin e përgjithshëm e inovativ të IA-së në ekonominë dhe administratën shqiptare.'

Ky objektivi i përgjithshëm zërthehet në disa objektiva specifike të matshëm e të kufizuar në kohë (kriteret SMART), si vijon:

1. Krijimi dhe funksionalizimi i plotë i autoriteteve kompetente (Struktura e IA-së/AKSHI, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Njoftues) brenda vitit 2028.
2. Regjistrimi i sistemeve IA me rrezik të lartë në regjistrin kombëtar, me synim afatgjatë 100% mbulim brenda vitit 2028.
3. Sigurimi që deri në fund të vitit 2028 të paktën 90% e sistemeve të inteligjencës artificiale me rrezik të lartë të identifikuar në sektorin publik dhe privat të kenë përmbushur kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për menaxhimin e riskut, transparencën, dokumentimin teknik dhe mbikëqyrjen njerëzore.
4. Sigurimi i periudhave tranzitore proporcionale (12 muaj për sistemet me rrezik të lartë, 24 muaj për sistemet ekzistuese në përgjithësi) për të lejuar adaptim të arsyeshëm nga operatorët ekonomikë.
5. Operacionalizimi i sandbox-it rregullator për IA, me synim pjesëmarrjen e 15-20 NVM-ve/start-up-eve brenda vitit 2028.
6. Trajnimi i personelit të autoriteteve kompetente dhe institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e ligjit, me synim që deri në fund të vitit 2028 të paktën 200 punonjës publikë të kenë përfunduar programe të specializuara mbi qeverisjen, mbikëqyrjen dhe përdorimin e sigurt të inteligjencës artificiale.
7. Sigurimi që deri në fund të vitit 2028 të gjitha institucionet publike që përdorin sisteme IA me ndikim në vendimmarrje administrative të publikojnë informacion bazë mbi përdorimin e tyre, përfshirë qëllimin, kategorinë e sistemit dhe masat e mbikëqyrjes njerëzore.
8. Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave për trajtimin e ankesave dhe shqyrtimin e rasteve që lidhen me përdorimin e sistemeve të IA-së, me synim që deri në fund të vitit 2028 të gjitha ankesat e regjistruara të trajtohen sipas procedurave të përcaktuara ligjërisht dhe brenda afateve përkatëse.
9. Mbështetja e zhvillimit dhe përdorimit të sistemeve të inteligjencës artificiale në institucionet publike në përputhje me kërkesat ligjore, me synim që deri në fund të vitit 2028 të paktën 10 institucione publike të kenë implementuar ose pilotuar zgjidhje IA.

Të gjithë objektivat e mësipërm shërbejnë drejtpërdrejt objektivin strategjik më të gjerë të qeverisë për avancimin e procesit të integritimit evropian (PKIE 2024-2026, kapitujt 10 dhe 28) dhe për zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Axhendën Dixhitale të Shqipërisë 2022-2026, e cila

identifikon shprehimisht hartimin e kuadrit rregullator për IA-në si një nga masat prioritare për ndërtimin e një ekonomie dixhitale konkurruese dhe të besueshme.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

OPSIONI 0 – STATUS QUO

Nuk ndërmerret asnjë ndërhyrje e re ligjore apo institucionale dhe sistemet e inteligjencës artificiale vazhdojnë të rregullohen nga kuadri ekzistues horizontal (mbrojtja e të dhënave personale, legjislacioni për konsumatorin dhe siguria e produkteve). Nuk parashikohet krijimi i autoriteteve të posaçme, regjistrave apo detyrimeve specifike për IA.

Ky opsion nuk sjell kosto buxhetore, por lë një boshllëk të qartë rregullator, me mungesë mbikëqyrjeje të dedikuar, pasiguri juridike për operatorët dhe përafrim të kufizuar me standardet e Bashkimit Evropian.

OPSIONI 1 – QASJE JORREGULLATORE

Ky opsion mbështetet në instrumente vullnetare si udhëzime, kode sjelljeje dhe rekomandime për zhvilluesit dhe përdoruesit e sistemeve IA, të hartuara nga AKSHI dhe institucionet përkatëse.

Megjithëse mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e praktikave të mira, ky opsion nuk krijon detyrime ligjore, nuk parashikon mekanizma sanksionues dhe nuk garanton zbatim të njëtrajtshëm. Si rrjedhojë, niveli i pajtueshmërisë varet plotësisht nga vullneti i operatorëve, duke kufizuar ndjeshëm efektivitetin e tij dhe duke mos siguruar përafrim të plotë me AI Act.

OPSIONI 2 – LIGJ I HARMONIZUAR ME AI ACT (I PREFERUAR)

Ky opsion konsiston në miratimin e një ligji të posaçëm për inteligjencën artificiale, të harmonizuar plotësisht me Rregulloren (BE) 2024/1689. Ai vendos një qasje të bazuar në risk, duke ndaluar praktikat me rrezik të papranueshëm dhe duke vendosur kërkesa të detajuara për sistemet me rrezik të lartë, përfshirë menaxhimin e riskut, transparencën, dokumentimin teknik dhe mbikëqyrjen njerëzore.

Gjithashtu, krijohen autoritete kompetente, mekanizma mbikëqyrjeje, regjistër kombëtar i sistemeve IA dhe sandbox-e rregullatore për inovacionin. Ky opsion siguron harmonizim të plotë me BE-në dhe rritje të ndjeshme të sigurisë juridike, duke balancuar mbrojtjen e të drejtave themelore me nxitjen e inovacionit. Megjithatë, ai shoqërohet me kosto më të larta institucionale dhe detyrime shtesë për operatorët ekonomikë.

OPSIONI 3 – HARMONIZIM I PJESSHËM PËRMES LEGJISLACIONIT SEKTORIAL

Ky opsion parashikon adresimin e çështjeve të inteligjencës artificiale përmes ndryshimeve në ligjet ekzistuese sektoriale, pa krijuar një kuadër të unifikuar horizontal. Ndërhyrjet do të shpërndahen në fusha si mbrojtja e të dhënave, siguria e produkteve, konsumatori dhe siguria kibernetike.

Ai lejon zgjidhje më të shpejta dhe kosto më të ulëta në afat të shkurtër, por sjell fragmentim rregullator, mungesë koherence dhe vështirësi në zbatim për autoritetet dhe bizneset. Gjithashtu, harmonizimi me AI Act mbetet i pjesshëm dhe nuk mbulon plotësisht mekanizmat kryesorë të tij, si klasifikimi i riskut apo mbikëqyrja e tregut.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Opsioni i preferuar (Opsioni 2) përfaqëson një ndërhyrje të plotë rregullatore për inteligjencën artificiale, e cila synon të adresojë boshllëkun aktual ligjor në Shqipëri dhe të krijojë një kuadër të

unifikuar për zhvillimin, përdorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të IA-së. Në kushtet kur teknologjitë e inteligjencës artificiale po përdoren gjithnjë e më shumë në sektorë kritikë si administrata publike, shëndetësia, financat, arsimit dhe punësimi, mungesa e rregullave të posaçme krijon një situatë pasigurie si për institucionet ashtu edhe për bizneset dhe qytetarët.

Në këtë kontekst, ndërhyrja rregullatore sjell një ndryshim të rëndësishëm institucional dhe financiar, pasi kërkon ngritjen e strukturave të reja të specializuara, forcimin e autoriteteve mbikëqyrëse dhe krijimin e instrumenteve të reja si regjistri kombëtar i sistemeve të IA-së, mekanizmat e auditimit dhe sandbox-et rregullatore. Këto masa shoqërohen me kosto fillestare dhe operative për administratën publike, të lidhura kryesisht me burime njerëzore të kualifikuara, infrastrukturë teknologjike dhe procese të vazhdueshme monitorimi. Megjithatë, në një perspektivë afatmesme dhe afatgjatë, këto investime pritet të sjellin përfitime të rëndësishme përmes rritjes së efikasitetit të kontrollit, reduktimit të rreziqeve dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike.

Për sektorin privat, ndikimi është i strukturuar sipas nivelit të riskut të sistemeve të inteligjencës artificiale. Bizneset që përdorin sisteme me rrezik të ulët ose të kufizuar përballen kryesisht me detyrime minimale administrative, ndërsa subjektet që zhvillojnë ose përdorin sisteme me rrezik të lartë duhet të përmbushin kërkesa më të avancuara, si dokumentim teknik, menaxhim të detajuar të riskut, transparencë algoritmike, gjurmueshmëri të të dhënave dhe procedura të vlerësimit të konformitetit. Këto kërkesa rrisin kostot e përputhshmërisë, por njëkohësisht krijojnë një treg më të sigurt dhe më të besueshëm, duke ulur rrezikun ligjor dhe duke përmirësuar mundësitë për akses në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht në Bashkimin Evropian.

Në aspektin social, ndikimi i opsionit është kryesisht pozitiv, pasi forcohet mbrojtja e të drejtave themelore të qytetarëve, përfshirë privatësinë, mosdiskriminimin dhe aksesin e barabartë në shërbime. Vendosja e kërkesave për transparencë dhe mbikëqyrje njerëzore në vendimmarrjen e automatizuar redukton rrezikun e vendimeve të padrejta ose të paqarta, veçanërisht në fusha të ndjeshme si punësimi, kreditimi, arsimit dhe shërbimet publike. Kjo kontribuon gjithashtu në rritjen e besimit të publikut ndaj teknologjive digjitale, i cili është një faktor kyç për adoptimin e suksesshëm të inteligjencës artificiale.

Nga këndvështrimi ligjor dhe i tregut, kuadri i ri rrit sigurinë juridike për të gjithë aktorët, duke vendosur rregulla të qarta dhe të parashikueshme për mënyrën e funksionimit të sistemeve të IA-së. Ai harmonizohet me standardet e Bashkimit Evropian, duke reduktuar fragmentimin rregullator dhe duke krijuar kushte më të favorshme për integrimin ekonomik dhe teknologjik. Në të njëjtën kohë, kjo qasje nuk kufizon hyrjen në treg, por përkundrazi synon të krijojë një ambient konkurrues më të drejtë dhe më të strukturuar.

Në terma të konkurrencës dhe zhvillimit ekonomik, ndikimi është i balancuar. Megjithëse rriten kërkesat për përputhshmëri, veçanërisht për sistemet me rrezik të lartë, këto masa aplikohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët, duke shmangur diskriminimin dhe duke ruajtur neutralitetin e tregut. Në afat më të gjatë, standardizimi dhe harmonizimi me BE-në pritet të ulë kostot e përshtatjes, të nxisë inovacionin dhe të lehtësojë zhvillimin e një industrie më të qëndrueshme të inteligjencës artificiale në vend.

Në përgjithësi, Opsioni 2 përfaqëson një qasje të balancuar mes kostove afatshkurtra të zbatimit dhe përfitimeve afatgjata në aspektin institucional, ekonomik, social dhe teknologjik. Ai synon të adresojë rreziqet që lidhen me përdorimin e pakontrolluar të inteligjencës artificiale, duke garantuar njëkohësisht zhvillim të qëndrueshëm, rritje të besimit publik dhe përafrim të plotë me kuadrin evropian.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Bazuar në analizën e kryer, Opsioni 2 – hartimi i një ligji të ri të harmonizuar plotësisht me EU AI Act – del qartë si alternativa më e përshtatshme për t’u zbatuar. Ky opsion është i vetmi që adreson në mënyrë të plotë dhe të unifikuar të gjitha dimensionet kryesore të problematikës aktuale: mbrojtjen e të drejtave themelore, mbikëqyrjen e sistemeve me rrezik të lartë, sigurinë juridike për operatorët ekonomikë dhe përputhshmërinë me procesin e integritimit evropian. Ndërsa opsionet e tjera ose nuk ndërhyjnë fare, ose ofrojnë zgjidhje të pjesshme dhe jo detyruese, vetëm Opsioni 2 krijon një kuadër gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm rregullator për inteligjencën artificiale.

Nga këndvështrimi i kostove dhe përfitimeve, ndërhyrja rregullatore vlerësohet si e menaxhueshme, me kosto kryesisht institucionale dhe organizative që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të reja dhe funksionimin e strukturave mbikëqyrëse. Këto kosto janë të shpërndara në kohë dhe mund të mbështeten edhe përmes instrumenteve të asistencës së Bashkimit Evropian. Në të kundërt, mosveprimi mbart kosto të fshehura dhe potencialisht të larta, të lidhura me rrezikun e shkeljes së të drejtave themelore, mungesën e mbrojtjes ndaj sistemeve të pasigurta, humbjen e konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare dhe vonesa në procesin e integritimit evropian.

Opsioni i preferuar siguron gjithashtu zbatimin e parimit të proporcionalitetit, pasi rregullimi bazohet në qasjen sipas nivelit të rrezikut: shumica e operatorëve ekonomikë nuk përballen me barrë të konsiderueshme, ndërsa kërkesat më të rrepta fokusohen vetëm tek sistemet me rrezik të lartë. Kjo e bën ndërhyrjen njëkohësisht të balancuar dhe të targetuar.

Në vlerësimin krahasues me shumë kritere, Opsioni 2 rezulton me performancën më të lartë në të gjitha fushat kryesore, veçanërisht në harmonizimin me acquis të BE-së, sigurinë juridike, ndikimin pozitiv në inovacion dhe zhvillimin e tregut, si dhe në efektivitetin e koston afatgjatë. Për këto arsye, ai konsiderohet opsioni më i qëndrueshëm dhe strategjikisht më i favorshëm për zhvillimin e sektorit të inteligjencës artificiale në Shqipëri.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

Commented [FS1]: Do te plotesohet nga Drejtoret Teknik

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Konsultimi mbi këtë projektligj është organizuar në përputhje me Ligjin nr. 146/2014 'Për njoftimin dhe konsultimin publik'. Drafti i projektligjit, së bashku me këtë Raport të Vlerësimit të Ndikimit, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP), me një periudhë konsultimi minimale prej 20 ditësh (29.05.2026 -26.06.2026), gjatë së cilës çdo person fizik apo juridik i interesuar ka pasur mundësi të paraqesë komente me shkrim.

Më datë 12.06.2026 AKSHI organizoi Tryezën e Parë të Konsultimit Publik për projektligjin “Për Inteligjencën Artificiale”, një nismë strategjike në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së, në fushën e Inteligjencës Artificiale, në kuadër të Kapitullit 10 – Transformimi Digjital dhe Media. Tryeza bëri bashkë përfaqësues të institucioneve publike, akademisë, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës, duke reflektuar interesin në rritje për zhvillimin e një

kuadri rregullator modern dhe të besueshëm për Inteligjencën Artificiale në Shqipëri.

Kontributet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve ishin...

Në vijim të procesit të konsultimit publik për projektligjin “Për Inteligjencën Artificiale”, më datë 17.06.2026, AKSHI organizoi Tryezën e Dytë të Konsultimit, duke sjellë në një dialog të hapur përfaqësues të komunitetit akademik, pedagogë, studiues, ekspertë dhe studentë nga degët e lidhura me teknologjinë, inteligjencën artificiale, shkencat kompjuterike, inxhinierinë dhe fusha të tjera të ndërlidhura, nga universitetet kryesore të vendit.

Kjo tryezë vendosi në qendër të diskutimit rolin e universiteteve dhe të rinjve si aktorë kyç në formësimin e së ardhmes digjitale të Shqipërisë dhe në zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të mbështetur nga Inteligjenca Artificiale.

Diskutimet u fokusuan në sfidat dhe mundësitë që sjell Inteligjenca Artificiale, ndikimin e saj në arsim, tregun e punës, zhvillimin ekonomik dhe inovacionin, si dhe në nevojën për garantimin e standardeve të larta të sigurisë, etikës, transparencës dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e saj.

Kontributet dhe rekomandimet e paraqitura nga komuniteti akademik...

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Struktura institucionale e zbatimit Zbatimi efektiv i ligjit kërkon angazhimin e koordinuar të disa institucioneve, secila me role të përcaktuara qartë nga vetë projektligji:

AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), në cilësinë e 'Strukturës së IA-së' siç përkufizohet në projektligj do të jetë autoriteti kryesor koordinues teknik, përgjegjës për mbajtjen e regjistrit kombëtar të sistemeve IA, funksionimin e sandbox-it rregullator, monitorimin e ofruesve të modeleve IA me qëllim të përgjithshëm dhe lehtësimin e hartimit të kodeve të sjelljes e udhëzimeve praktike =.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut do të kryejë mbikëqyrjen ex-post të sistemeve IA të vendosura në treg, përfshirë vlerësimin e sistemeve që paraqesin rrezik, trajtimin e mospërputhjeve formale, dhe vendosjen e sanksioneve administrative.

Autoriteti Njoftues: përgjegjës për akreditimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit ('organe të njoftuara') që do të kryejnë vlerësimet e konformitetit për sistemet IA me rrezik të lartë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale: do të vazhdojë të mbikëqyrë aspektet e përpunimit të të dhënave personale brenda sistemeve IA (në veçanti lidhur me kategoritë speciale të të dhënave dhe sistemet biometrike, në bashkëpunim dhe koordinim me autoritetet e tjera kompetente.

Gjykatat administrative: do të jenë instanca e ankimit për vendimet e autoriteteve kompetente.

Monitorimi i vazhdueshëm do të bazohet në instrumentet e parashikuara nga vetë projektligji: regjistri kombëtar i sistemeve IA, i cili do të shërbejë si burimi kryesor i të dhënave për numrin dhe llojin e sistemeve IA aktive në Shqipëri; raportimi i incidenteve serioze nga ofruesit, që do të mundësojë identifikimin e hershëm të problematikave sistematike; dhe ankesat e qytetarëve drejtuar autoritetit të mbikëqyrjes së tregut (neni 85), si tregues i drejtpërdrejtë i perceptimit dhe i ndikimit real të ligjit mbi qytetarët.

Vlerësimi pas zbatimit (post-implementation review), do të kryhet jo më herët se 3 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit dhe do të adresojë pyetjet standarde të Metodologjisë: nëse problemi fillestar (boshllëku

rregullator) është adresuar realisht; nëse objektivat SMART të përcaktuar më sipër janë arritur (p.sh. % e sistemeve me rrezik të lartë të regjistruara, numri i NVM-ve që kanë përdorur sandbox-in, numri i ankesave të trajtuara); dhe nëse kanë lindur ndikime ose pengesa të paparashikuara që kërkojnë ndryshime (lista e sistemeve me rrezik të lartë) përmes mekanizmit të parashikuar në nenin 7 të projektligjit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Inteligjenca artificiale ka kaluar, gjatë dekadës së fundit, nga një fushë kryesisht akademike dhe eksperimentale në një teknologji me përdorim masiv tregtar, ekonomik dhe shoqëror, e integruar në vendimmarrjen e përditshme të bizneseve, institucioneve publike dhe konsumatorëve. Ajo përdoret gjerësisht në sisteme rekomandimi dhe motorë kërkimi, modele të mëdha gjuhësore (Large Language Models), sisteme të njohjes së fytyrës, automatizimin e proceseve të rekrutimit, vlerësimin e kreditit, diagnostikimin mjekësor, sigurinë kibernetike, transportin inteligjent dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Në nivel global, investimet në inteligjencën artificiale janë rritur ndjeshëm, ndërsa teknologjitë gjeneruese të IA-së kanë përshpejtuar adoptimin e saj nga sektori privat dhe publik. Kjo ka krijuar mundësi të konsiderueshme për rritjen e produktivitetit, inovacionit, uljen e kostove operative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Megjithatë, paralelisht janë shtuar edhe shqetësimet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, diskriminimin algoritmik, mungesën e transparencës së sistemeve të IA-së, sigurinë kibernetike, përgjegjësinë juridike për vendimet e automatizuara dhe ndikimin në tregun e punës.

Edhe në Shqipëri, përdorimi i inteligjencës artificiale po bëhet gjithnjë e më i pranishëm. Institucionet publike po eksplorojnë mundësitë e përdorimit të saj në kuadër të transformimit dixhital dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike, ndërsa sektori privat po adopton zgjidhje të bazuara në IA në fusha si telekomunikacioni, bankat, tregtia elektronike, marketingu dixhital, analiza e të dhënave dhe shërbimi ndaj klientit. Gjithashtu, përdorimi i aplikacioneve gjeneruese të inteligjencës artificiale nga qytetarët, bizneset dhe institucionet është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit.

Në nivel ndërkombëtar, Bashkimi Evropian miratoi më 13 qershor 2024 Rregulloren (BE) 2024/1689, e njohur gjerësisht si 'Akti i BE-së për Inteligjencën Artificiale' (EU AI Act), akti i parë gjithëpërfshirës rregullator për IA-në në botë, i cili vendos një kuadër ligjor bazuar në një qasje të shkallëzuar sipas nivelit të rrezikut (risk-based approach): praktika të ndaluara, sisteme me rrezik të lartë subjekt detyrimesh të rrepta, sisteme me rrezik të kufizuar subjekt detyrimesh transparence, dhe sisteme me rrezik minimal pa detyrime shtesë. EU AI Act-i ka hyrë në fuqi me afate të shkallëzuara zbatimi për shtetet anëtare, ndalimet e para (praktikat me rrezik të papranueshëm) duke u zbatuar më herët se kërkesat e plota për sistemet me rrezik të lartë.

Republika e Shqipërisë, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe palë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), ka detyrimin e vazhdueshëm për përafrimin progresiv të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*, përfshirë legjislacionin e ri që rregullon tregun e brendshëm dixhital të BE-së. Aktualisht, kuadri ligjor shqiptar përfshin disa akte që prekin tërthorazi disa nga aspektet e IA-së Ligji nr. 124/2024 'Për mbrojtjen e të dhënave personale' (që rregullon përpunimin e të dhënave, përfshirë ato të përdorura për trajnimin e modeleve IA), legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit, dhe legjislacioni për sigurinë e produkteve, por asnjë prej tyre nuk e trajton sistemin IA si objekt më vete rregullimi, me karakteristikat dhe rreziqet e tij specifike (autonomi vendimmarrëse, mësim i vazhdueshëm nga të dhënat, mungesë transparence e funksionimit të brendshëm – fenomeni 'black box').

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*

- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra dhe shtrirja e problemit

Problemi kryesor i identifikuar është rregullator dhe rrjedh nga mungesa e një kuadri ligjor të posaçëm dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin, vendosjen në treg, përdorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, legjislacioni shqiptar nuk përmban dispozita specifike që të adresojnë rreziqet, detyrimet dhe përgjegjësitë që lidhen me inteligjencën artificiale, ndërkohë që përdorimi i këtyre teknologjive po zgjerohet me shpejtësi në sektorin publik dhe privat.

Megjithëse disa aspekte të lidhura me inteligjencën artificiale trajtohen pjesërisht nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë kibernetike dhe sigurinë e produkteve, ky kuadër mbetet i fragmentuar dhe nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë karakteristikat dhe rreziqet specifike të sistemeve të inteligjencës artificiale. Si rrjedhojë, mungojnë rregulla të qarta për klasifikimin e sistemeve sipas nivelit të rrezikut, kërkesat për transparencë, mbikëqyrjen njerëzore, menaxhimin e rrezikut, cilësinë e të dhënave, vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut.

Shtrirja e problemit është e gjerë dhe prek një numër të konsiderueshëm aktorësh. Sistemet e inteligjencës artificiale përdoren ose pritet të përdoren në fusha të tilla si shërbimet publike dixhitale, arsimi, shëndetësia, sektori financiar, punësimi, tregtia elektronike, telekomunikacioni, siguria kibernetike dhe administrimi i të dhënave. Në këto sektorë, sistemet e IA-së mund të ndikojnë drejtpërdrejt në vendime që prekin të drejtat, mundësitë ekonomike dhe aksesin e individëve në shërbime publike dhe private.

Mungesa e një kuadri të dedikuar rregullator krijon rrezikun që në tregun shqiptar të zhvillohen ose përdoren sisteme të inteligjencës artificiale pa standarde të qarta sigurie, transparence dhe përgjegjshmërie. Kjo mund të sjellë pasoja si cenimi i të drejtave themelore, trajtimi diskriminues i individëve, përdorimi i sistemeve me rrezik të lartë pa mekanizma të përshtatshëm kontrolli, si dhe mungesë të mbrojtjes efektive të qytetarëve ndaj vendimeve të automatizuara.

Këto problematika manifestohen konkretisht në disa dimensione të ndërlidhura:

1. **Rreziku i cenimit të të drejtave themelore të njeriut nga përdorimi i sistemeve të inteligjencës artificiale.**

Sistemet e inteligjencës artificiale mund të ndikojnë në ushtrimin e një game të gjerë të drejtash themelore, përfshirë të drejtën për dinjitet njerëzor, privatësi, mbrojtjen e të dhënave personale, mosdiskriminimin, lirinë e shprehjes, aksesin në drejtësi dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Përdorimi i sistemeve të automatizuara në procese si rekrutimi, vlerësimi i kreditit, ofrimi i përfitimeve sociale, kontrolli kufitar apo mbikëqyrja publike mund të prodhojë rezultate diskriminuese, të padrejta ose jo transparente, veçanërisht kur vendimmarrja mbështetet në të dhëna të paplota, të njëanshme ose historikisht të paragjykuara.¹

Në mungesë të një kuadri të posaçëm rregullator dhe të ndalimeve ligjore të qarta, aktualisht nuk ekzistojnë mekanizma që të pengojnë zhvillimin, vendosjen në treg ose përdorimin në Republikën e Shqipërisë të sistemeve të inteligjencës artificiale që, për shkak të natyrës së tyre, paraqesin rrezik të papranueshëm për të drejtat themelore, dinjitetin njerëzor, privatësinë, lirinë individuale dhe parimet demokratike. Përdorin teknika manipuluese subliminale për të shtrembëruar vendimmarrjen e personave;

- shfrytëzojnë dobësitë e personave për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar apo situatës socio-ekonomike;

¹ Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence - [Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence | Shaping Europe's digital future](#)

- krijojnë sisteme të 'vlerësimit social' (social scoring) që klasifikojnë qytetarët bazuar në sjelljen e tyre dhe i trajtojnë në mënyrë të padrejtë në kontekste të paqarta me ato ku janë mbledhur të dhënat;
- ose përdorin identifikim biometrik në kohë reale në hapësira publike pa autorizim gjyqësor paraprak.

Përvoja e vendeve të tjera që kanë adoptuar tashmë EU AI Act-in tregon se këto praktika nuk janë thjesht hipotetike, por kanë qenë objekt rastesh konkrete dokumentuar nga autoritetet e mbrojtjes së të dhënave dhe organizata të të drejtave dixhitale në BE përpara miratimit të Rregullores.

2. Mungesa e kërkesave për sistemet IA me rrezik të lartë.

Përdorimi i sistemeve të inteligjencës artificiale krijon rreziqe të shtuara për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve. Karakteristikat specifike të sistemeve të inteligjencës artificiale, si varësia nga cilësia e të dhënave, aftësia për të mësuar dhe përshtatur sjelljen gjatë funksionimit, kompleksiteti teknik dhe mungesa e transparencës në procesin e vendimmarrjes, mund të çojnë në rezultate të pasakta ose të paparashikueshme. Këto rreziqe mund të materializohen në forma të tilla si gabime në sistemet e diagnostikimit mjekësor, mosfunksionime në automjetet autonome, gabime në sistemet e kontrollit industrial apo cenime të sigurisë kibernetike. Kuadri ekzistues rregullator nuk adreson në mënyrë të plotë kërkesat specifike për sigurinë, besueshmërinë dhe monitorimin e vazhdueshëm të sistemeve të inteligjencës artificiale gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës.²

Sektorë si shëndetësia (sisteme mbështetëse për diagnostikim), sektori financiar (vlerësim krediti, zbulim mashtrimi), burimet njerëzore (filtrim CV-sh, vlerësim kandidatësh), arsimi (vlerësim automatik i nxënësve) dhe administrata publike (sisteme vendimmarrëse për shërbime sociale, azil, kontroll kufitar) janë fusha ku sistemet IA mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë e domethënës mbi jetën e individëve.

Sot, asnjë nga këto sisteme, pavarësisht përdorimit aktual ose të planifikuar nuk i nënshtrohet detyrimeve për: dokumentacion teknik, sistem menaxhimi risku të dokumentuar dhe të përditësuar, kontroll të cilësisë së të dhënave të trajnimit për shmangien e paragjyqimeve algoritmike, aftësi regjistrimi automatik të ngjarjeve për gjurmueshmëri, apo procedurë vlerësimi konformiteti përpara vendosjes në treg.

3. Pasiguria juridike për operatorët ekonomikë dhe rreziku i mospërputhshmërisë me tregun e BE-së.

Shopëritë shqiptare të teknologjisë që duan të ofrojnë shërbime IA në tregun e BE-së do të duhet, në çdo rast, të përmbushin kërkesat e Rregullores (BE) 2024/1689 për atë treg specifik. Mungesa e një kuadri kombëtar të harmonizuar do të thotë që këto sipërmarrje do të operojnë nën dy regjime paralele (njëri për tregun vendas, pa kërkesa, dhe tjetri për tregun e BE-së, me kërkesa të plota), gjë që rrit kostot e konformitetit, krijon konfuzion operacional dhe dekurajon zhvillimin e produkteve IA 'me origjinë shqiptare' të destinuara për eksport. Po ashtu, ofruesit e huaj të sistemeve IA që synojnë tregun shqiptar nuk kanë asnjë pikë referimi të qartë mbi detyrimet e tyre lokale.

4. Hendeku rregullator në raport me procesin e integritet evropian.

Kapitulli 10 ('Shoqëria e informacionit dhe media') dhe Kapitulli 28 ('Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit') të acquis të BE-së, të cilët janë pjesë e procesit të negociatave të anëtarësimit, përfshijnë tashmë kërkesa të lidhura me rregullimin e teknologjive dixhitale dhe mbrojtjen e konsumatorëve nga produkte/shërbime me rrezik. Mosveprimi në fushën e IA-së do të krijonte një 'borxh rregullator' në rritje,

² Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence - [Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence | Shaping Europe's digital future](#)

i cili do të duhej të mbyllej në një afat shumë më të shkurtër në një moment të mëvonshëm, me kosto më të larta dhe me më pak kohë për konsultim e adaptim të bizneseve.

5. Autoritetet publike nuk disponojnë kompetenca, procedura dhe kapacitete të mjaftueshme për të mbikëqyrur dhe garantuar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e inteligjencës artificiale

Mungesa e kërkesave të detyrueshme për dokumentimin, gjurmueshmërinë dhe transparencën e sistemeve të inteligjencës artificiale e bën të vështirë për autoritetet kompetente identifikimin, hetimin dhe sanksionimin e shkeljeve. Gjithashtu, autoritetet shpesh nuk disponojnë ekspertizën teknike, burimet njerëzore dhe instrumentet e nevojshme për të vlerësuar rreziqet që lidhen me përdorimin e këtyre sistemeve dhe për të ushtruar mbikëqyrje efektive.

6. Pasiguria juridike dhe mungesa e rregullave të qarta pengojnë zhvillimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale

Operatorët ekonomikë, zhvilluesit dhe përdoruesit e sistemeve të inteligjencës artificiale përballen me paqartësi lidhur me mënyrën se si legjislacioni ekzistues zbatohet ndaj këtyre teknologjive. Nuk ekzistojnë standarde të harmonizuara që të përcaktojnë qartë kërkesat për transparencën, sigurinë, mbikëqyrjen njerëzore, cilësinë e të dhënave apo menaxhimin e rrezikut. Kjo krijon pasiguri për bizneset, rrit kostot e pajtueshmërisë dhe frenon investimet dhe inovacionin në këtë sektor.

7. Mungesa e besimit të qytetarëve dhe organizatave ndaj inteligjencës artificiale ngadalëson përhapjen dhe zhvillimin e saj

Perceptimi se sistemet e inteligjencës artificiale mund të cenojnë sigurinë, privatësinë ose të drejtat themelore ul gatishmërinë e qytetarëve dhe organizatave për t'i përdorur ato. Mungesa e besimit kufizon kërkesën për produkte dhe shërbime të bazuara në inteligjencën artificiale, pengon inovacionin dhe redukton përfitimet ekonomike dhe shoqërore që mund të sjellë kjo teknologji.

8. Mungesa e një kuadri të harmonizuar rregullator krijon fragmentim rregullator dhe pengesa për zhvillimin e tregut

Në mungesë të një kuadri të unifikuar, shtetet mund të adoptojnë qasje të ndryshme rregullatore për inteligjencën artificiale, duke krijuar standarde dhe kërkesa të ndryshme. Kjo sjell rritje të kostove për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kufizon ofrimin ndërkufitar të produkteve dhe shërbimeve dhe pengon zhvillimin e një tregu të integruar dhe konkurrues për inteligjencën artificiale.³

Shkaqet e problemit

Lidhur me problematikat e paraqitura më lart janë identifikuar një sërë shkaqesh:

1. Mungesa e një kuadri të posaçëm ligjor për inteligjencën artificiale

Aktualisht në Republikën e Shqipërisë nuk ekziston një ligj i dedikuar që të rregullojë zhvillimin, vendosjen në treg, përdorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të inteligjencës artificiale. Për pasojë, çështje të tilla si klasifikimi i sistemeve sipas nivelit të rrezikut, detyrimet e ofruesve dhe përdoruesve, kërkesat për transparencë, mbikëqyrjen njerëzore dhe mekanizmat e kontrollit nuk janë të rregulluara në mënyrë të qartë.

³ Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence - [Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence | Shaping Europe's digital future](#)

2. Fragmentimi i legjislacionit ekzistues

Aspekte të ndryshme që lidhen me inteligjencën artificiale trajtohen pjesërisht nga akte të ndryshme ligjore, si legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë kibernetike, komunikimet elektronike dhe sigurinë e produkteve. Kjo qasje e fragmentuar nuk mundëson adresimin e plotë të rreziqeve dhe specifikave që lidhen me sistemet e inteligjencës artificiale dhe krijon pasiguri juridike për autoritetet, bizneset dhe qytetarët.

3. Mungesa e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e inteligjencës artificiale

Legjislacioni shqiptar nuk është ende i harmonizuar me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren (BE) 2024/1689 (AI Act). Si rezultat, mungojnë rregullat për identifikimin dhe menaxhimin e sistemeve me rrezik të lartë, ndalimin e praktikave me rrezik të papranueshëm, kërkesat për transparencë, procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së tregut.

4. Kapacitete të kufizuara institucionale për mbikëqyrjen e inteligjencës artificiale

Mungesa e një kuadri të dedikuar shoqërohet edhe me mungesën e kompetencave të përcaktuara qartë, procedurave dhe instrumenteve të nevojshme për monitorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të inteligjencës artificiale nga institucionet përgjegjëse.

1. Mungesa e transparencës ("black box")

Shpesh nuk është e qartë se si sistemi i IA-së ka arritur në një përfundim ose vendim të caktuar.

Shembull: Një sistem refuzon një aplikim për kredi ose nuk përzgjedh një kandidat për punë, por nuk mund të shpjegojë arsyet konkrete të vendimit.

Problemi që krijon: Është e vështirë të kontrollohet nëse vendimi ka qenë i drejtë, ligjor apo diskriminues.

2. Kompleksiteti teknik i sistemeve

Sistemet e IA-së përbëhen nga algoritme dhe procese shumë të ndërlikuara, të cilat shpesh nuk kuptohen plotësisht as nga përdoruesit dhe në disa raste as nga vetë zhvilluesit.

Shembull: Një model i madh gjuhësor mund të përdorë miliarda parametra për të prodhuar një përgjigje.

Problemi që krijon: Autoritetet mbikëqyrëse dhe përdoruesit e kanë të vështirë të identifikojnë gabimet ose shkeljet.

7. Aftësia për t'u përshtatur dhe ndryshuar me kalimin e kohës

Disa sisteme IA mësojnë nga të dhënat e reja dhe mund të ndryshojnë mënyrën e funksionimit pas vendosjes në përdorim.

Shembull: Një sistem për zbulimin e mashtrimeve bankare mund të ndryshojë kriteret e vlerësimit ndërsa merr të dhëna të reja.

Problemi që krijon: Një sistem që fillimisht është i sigurt mund të fillojë të prodhojë rezultate të paparashikuara ose të gabuara.

8. Autonomia në marrjen e vendimeve

Sistemet e IA-së mund të gjenerojnë rekomandime ose vendime me ndërhyrje të kufizuar njerëzore.

Shembull: Një sistem mund të rendisë automatikisht aplikantët për një vend pune ose të përcaktojë nivelin e rrezikut të një klienti.

Problemi që krijon: Vendime me ndikim të madh mbi individët mund të merren pa kontroll të mjaftueshëm njerëzor.

9. Varësia nga të dhënat dhe cilësia e tyre

IA funksionon mbi bazën e të dhënave që përdoren për trajnim dhe funksionim.

Shembull: Nëse të dhënat historike të rekrutimit favorizojnë burrat, sistemi mund të mësojë të favorizojë burrat edhe në të ardhmen.

Problemi që krijon: Sistemi mund të riprodhojë ose përforcojë paragjykime, gabime dhe diskriminime ekzistuese.⁴

2.2 Grupet e prekura nga problemi

Grupet kryesore të prekura nga problemi (dhe që do të preken nga zgjidhja e propozuar) janë:

- a) qytetarët shqiptarë, si subjekte potenciale të vendimeve të marra ose asistuar nga sisteme IA (kredi, punësim, shërbime publike, vlerësime arsimore);
- b) operatorët ekonomikë vendas që zhvillojnë, importojnë, shpërndajnë ose përdorin sisteme IA, përfshirë veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe start-up-et e teknologjisë;
- c) institucionet publike, si përdorues aktualë ose potencialë të sistemeve IA në kuadër të transformimit dixhital të shërbimeve publike;
- d) ofruesit e huaj të sistemeve IA që operojnë ose synojnë të hyjnë në tregun shqiptar; dhe
- e) vetë administrata shtetërore, e cila do të duhet të krijojë dhe të mirëmbajë kapacitetet e reja institucionale rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendësi punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë konsiderohet e nevojshme pasi zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve të inteligjencës artificiale po rritet me shpejtësi në sektorë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi të drejtat e qytetarëve, sigurinë publike, ofrimin e shërbimeve dhe funksionimin e tregut. Në mungesë të një kuadri të posaçëm ligjor, operatorët ekonomikë, institucionet publike dhe qytetarët përballen me pasiguri juridike lidhur me kushtet, kufizimet dhe përgjegjësitë që lidhen me zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Legjislacioni aktual shqiptar trajton vetëm në mënyrë të pjesshme disa aspekte të lidhura me inteligjencën artificiale, përmes akteve që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë kibernetike dhe sigurinë e produkteve. Megjithatë, ky kuadër i fragmentuar nuk adreson karakteristikat specifike të sistemeve të inteligjencës artificiale, si automatizimi i vendimmarrjes, mungesa e transparencës së algoritmeve, përdorimi i të dhënave në shkallë të gjerë dhe rreziqet për të drejtat themelore.

⁴ Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence - [Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence | Shaping Europe's digital future](#)

Në mungesë të ndërhyrjes së qeverisë ekziston rreziku që në tregun shqiptar të zhvillohen dhe përdoren sisteme të inteligjencës artificiale pa standarde të qarta sigurie, transparence dhe përgjegjshmërie. Kjo mund të çojë në cenimin e të drejtave themelore të individëve, përdorimin e praktikave me rrezik të papranueshëm, trajtim diskriminues, mungesë të mbikëqyrjes efektive të sistemeve me rrezik të lartë, si dhe ulje të besimit të publikut ndaj teknologjive të inteligjencës artificiale.

Ndërhyrja e qeverisë synon gjithashtu të shmangë zhvillimin e një kuadri të fragmentuar rregullator, ku çështje të ndryshme të inteligjencës artificiale trajtohen nga akte të ndryshme ligjore pa një qasje të unifikuar. Një situatë e tillë do të krijonte paqartësi për bizneset, do të rriste kostot e pajtueshmërisë dhe do të pengonte zhvillimin e inovacionit dhe investimeve në këtë sektor.

Përmes kësaj ndërhyrje, qeveria synon të përcaktojë detyrimet e aktorëve që zhvillojnë ose përdorin sisteme të inteligjencës artificiale, të garantojë mbrojtjen e të drejtave themelore dhe sigurinë e qytetarëve, të forcojë besimin në përdorimin e teknologjive të inteligjencës artificiale, si dhe të sigurojë përafrimin e legjislacionit shqiptar me Rregulloren (BE) 2024/1689 (AI Act), në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Përvoja e Bashkimit Evropian ka treguar se mungesa e një kuadri të harmonizuar për inteligjencën artificiale krijon pasiguri juridike për zhvilluesit, ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve të inteligjencës artificiale, si dhe vështirësi në garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së të drejtave themelore. Për këtë arsye, Bashkimi Evropian miratoi Rregulloren (BE) 2024/1689 (AI Act), me qëllim krijimin e një kuadri të unifikuar rregullator që vendos kërkesa të përbashkëta për zhvillimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Në kushtet kur Shqipëria synon integrimin në Bashkimin Evropian dhe përafrimin progresiv me *acquis communautaire*, mungesa e një kuadri të ngjashëm kombëtar krijon një hendek rregullator ndërmjet legjislacionit shqiptar dhe atij evropian. Ky hendek mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e tregut dixhital, në investimet në teknologji dhe inovacion, si dhe në aftësinë e operatorëve ekonomikë shqiptarë për të ofruar produkte dhe shërbime në përputhje me standardet evropiane.

Për rrjedhojë, ndërhyrja e qeverisë synon jo vetëm adresimin e rreziqeve që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale, por edhe krijimin e një kuadri rregullator të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian, i cili garanton siguri juridike, mbrojtje të të drejtave themelore, besim në teknologji dhe zhvillim të qëndrueshëm të inovacionit dixhital.

Sipas Hapit 1 të Metodologjisë së VN-së, ndërhyrja e qeverisë justifikohet kur tregu, i “lënë vetëm” (i parregulluar ose pa masa korrigjuese nga qeveria), nuk arrin të prodhojë rezultate optimale për shoqërinë (dështim tregu) ose kur ekzistojnë angazhime të tjera politike/ligjore që e bëjnë ndërhyrjen të domosdoshme. Në rastin konkret, ekzistojnë disa arsye të qarta dhe të ndërlydhura për ndërhyrje rregullatore:

Asimetria e informacionit: Përdoruesit fundorë dhe personat e prekur nga sistemet IA (p.sh. një kandidat për punë i vlerësuar nga një algoritëm filtrimi, ose një aplikues për kredi i vlerësuar nga një model 'credit scoring') nuk kanë mundësi reale të kuptojnë si funksionon sistemi, çfarë të dhënash përdor, apo si mund të kontestojnë një vendim. Kjo asimetri thelbësore informacioni midis ofruesve/përdoruesve të sistemeve IA, nga njëra anë, dhe personave të prekur, nga ana tjetër, nuk korrigjohet nga vetë tregu, pasi nuk ka stimuj komercialë automatikë për 'transparencë vullnetare' kur kjo mund të zbulojë informacion konkurrues ose mund të ekspozojë praktika të paligjshme.

Eksternalitetet negative (efektet e jashtme): Kur një sistem IA me rrezik të lartë dështon ose prodhon rezultate diskriminuese (p.sh. një sistem rekrutimi që sistematikisht diskriminon kandidatët të caktuar, ose një sistem identifikimi biometrik që identifikon gabimisht persona në kontekstin e zbatimit të ligjit), kostoja e këtij dështimi nuk internalizohet plotësisht nga ofruesi ose përdoruesi i sistemit, por shpërndahet mbi individët e prekur dhe mbi shoqërinë në tërësi (humbje besimi në institucione, kosto gjyqësore, dëme reputacionale për vendin). Kërkesat e menaxhimit të riskut, cilësisë së të dhënave dhe regjistrimit të incidenteve serioze synojnë t'i internalizojnë këto kosto duke i shtyrë operatorët të parandalojnë dëmet përpara se ato të ndodhin.

Të mira publike dhe mbrojtja e të drejtave themelore si interes shtetëror: Mbrojtja e demokracisë, e shtetit të së drejtës dhe e të drejtave themelore (mosdiskriminimi, privatësia, liria e vetëvendosjes) janë funksione thelbësore të shtetit që nuk mund t'i lihen vetëm-rregullimit privat. Ndalimet absolute (p.sh. kundër scoring social ose manipulimit subliminal) janë shembull tipik i një kufiri që vetëm shteti, mund ta vendosë në mënyrë të detyrueshme dhe të zbatueshme.

Detyrimet ndërkombëtare dhe të integritimit evropian: Përtej dështimeve klasike të tregut, ekziston një bazë e dytë, plotësuese, për ndërhyrje: angazhimet e marra nga Shqipëria në kuadër të MSA-së dhe procesit të integritimit në BE për përafrimin progresiv të legjislacionit me *acquis communautaire*. Kjo nuk është thjesht 'e dëshirueshme' por është një detyrim i vazhdueshëm politik dhe ligjor i vendit, që ndikon drejtpërdrejt te vlerësimet periodike të Komisionit Evropian mbi përafrimin e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit.

Lidhja e nismës me dokumente politike të rëndësishme të lartë:

Kjo nismë është ndërmarrë në kuadër të zbatimit të **Strategjisë Ndërsektoriale për Axhendën Dixhitale të Shqipërisë 2022–2026**, e cila përbën një nga instrumentet kryesore zbatuese të prioriteteve të përcaktuara në Programin e Qeverisë në fushën e transformimit digjital, inovacionit dhe modernizimit të shërbimeve publike. Strategjia parashikon në mënyrë eksplicite zhvillimin e një kuadri ligjor kombëtar për inteligjencën artificiale, të harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si masë prioritare për forcimin e qeverisjes digjitale dhe nxitjen e ekonomisë së bazuar në inovacion. Në këtë kuptim, nisma ligjore është gjithashtu e lidhur ngushtë me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së në fushën e teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale.

Kjo nismë lidhet në mënyrë indirekte, por të qartë politike dhe strategjike me **Programin e Qeverisë 2025–2029**, i cili përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit të vendit në fusha si transformimi digjital, modernizimi i administratës publike, rritja e inovacionit dhe zhvillimi i ekonomisë digjitale, si dhe përafrimi me standardet dhe kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian. Në këtë kontekst, nisma nuk buron drejtpërdrejt nga Programi i Qeverisë si akt teknik, por është i lidhur me të përmes objektivave strategjikë që ai përcakton, duke reflektuar prioritetet politike të qeverisë në fushën e digjitalizimit dhe inovacionit.

Programi i Qeverisë shërben si dokument orientues i nivelit më të lartë politik, i cili përcakton prioritetet dhe vizionin e përgjithshëm, ndërsa Strategjia Ndërsektoriale për Axhendën Dixhitale të Shqipërisë 2022–2026 përbën instrumentin kryesor të zbatimit të këtyre prioriteteve në fushën e teknologjisë dhe shërbimeve digjitale. Në këtë zinxhir institucional, strategjia përkthen objektivat politikë në masa konkrete dhe të matshme, ndërsa projektligji për inteligjencën artificiale përfaqëson një nga instrumentet normative që mundëson realizimin praktik të këtyre masave, veçanërisht në drejtim të krijimit të një kuadri rregullator të posaçëm për IA-në.

Përveç lidhjes me Programin e Qeverisë dhe Strategjinë e Axhendës Dixhitale, kjo nismë ka një ndërthurje të gjerë edhe me dokumente të tjera strategjike dhe politika publike. Së pari, ajo lidhet ngushtë me kuadrin e integritimit evropian të Shqipërisë, duke qenë se synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e teknologjive digjitale, në veçanti me Rregulloren e BE-së për Inteligjencën Artificiale (AI Act). Ky përafrim synon krijimin e një kuadri rregullator të harmonizuar me standardet evropiane, duke lehtësuar integrimin e mëtejshëm të Shqipërisë në tregun e përbashkët digjital evropian dhe duke garantuar një nivel të lartë mbrojtjeje dhe sigurie në përdorimin e teknologjive të IA-së.

Së dyti, nisma lidhet me strategjitë sektoriale të digjitalizimit dhe inovacionit, të cilat përfshijnë zhvillimin e e-qeverisjes, nxitjen e inovacionit teknologjik dhe forcimin e sigurisë kibernetike. Në këtë kuadër, inteligjenca artificiale konsiderohet si një teknologji horizontale, e cila ndikon dhe ndërhyr në mënyrë tërthore në një gamë të gjerë sektorësh publikë dhe privatë.

Së treti, nisma është e lidhur me politikat dhe reformat e administratës publike, veçanërisht në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve publike dhe rritjes së eficiencës institucionale, ku përdorimi i teknologjive të

inteligjencës artificiale shihet si një instrument për automatizimin e proceseve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Së fundi, nisma kontribuon në objektivat e **Agjendës Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social**, duke mbështetur rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë, zhvillimin e ekonomisë së dijes dhe forcimin e kapaciteteve të inovacionit, si elementë kyç për zhvillimin afatgjatë të vendit.

Deri më sot, Qeveria e Shqipërisë dhe administrata publike kanë ndërmarrë një sërë hapash strategjikë, institucionale dhe bashkëpunues për të krijuar bazat e zhvillimit të inteligjencës artificiale dhe integritit të saj në shërbimet publike dhe kuadrin rregullator kombëtar. Këto ndërhyrje janë zhvilluar kryesisht në kuadër të procesit të transformimit digjital dhe përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian.

Puna ekzistuese e kryer deri më tani:⁵

Në nivel strategjik, zhvillimi i IA-së është adresuar përmes **Strategjisë Ndërsektoriale për Axhendën Dixhitale të Shqipërisë 2022–2026**, e cila e konsideron inteligjencën artificiale si një nga teknologjitë kyçe për modernizimin e administratës publike, rritjen e efikasitetit të shërbimeve dhe zhvillimin e ekonomisë digjitale. Në këtë dokument parashikohet në mënyrë eksplicite nevoja për hartimin e një kuadri ligjor dhe rregullator për IA-në, të harmonizuar me legjislacionin e BE-së.

Paralelisht, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në kuadër të **programeve të e-qeverisjes dhe digjitalizimit të shërbimeve publike**, ku teknologjitë e avancuara, përfshirë elementë të IA-së, janë përdorur në mënyrë graduale për automatizimin e proceseve administrative, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe rritjen e ndërveprimit digjital me qytetarët dhe bizneset. Këto zhvillime janë pjesë e platformës së përgjithshme të transformimit digjital të administratës publike.

Shqipëria ka ndërmarrë reforma dhe investime të rëndësishme në lidhje me transformimin digjital dhe modernizimin e infrastrukturës së shërbimeve publike, të cilat janë të mbështetura dhe të orientuara nga Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 01.06.2022. Kjo agjendë përbën dokumentin kryesor strategjik në fushën e digjitalizimit dhe përcakton një qasje gjithëpërfshirëse për vijimin e reformave në qeverisjen elektronike, duke synuar jo vetëm konsolidimin e arritjeve ekzistuese, por edhe avancimin e mëtejshëm të përdorimit të teknologjive të reja në administratën publike. Në mënyrë të veçantë, ajo parashikon integrimin e teknologjive të avancuara si inteligjenca artificiale, përpunimi i të dhënave në shkallë të gjerë (big data), automatizimi dhe zgjidhjet digjitale të gjeneratës së re, si dhe forcimin e kapaciteteve digjitale të administratës dhe qytetarëve, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike.

Zbatimi i kësaj agjende udhëhiqet dhe monitorohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), e cila luan rol qendror në zhvillimin, operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale të shtetit shqiptar. AKSHI siguron funksionimin e vazhdueshëm të sistemeve elektronike, koordinon zhvillimin e platformave të reja dhe garanton integritetin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve digjitale për qytetarët, bizneset dhe administratën publike.

Në këtë kuadër, Shqipëria ka avancuar ndjeshëm në digjitalizimin e shërbimeve publike, ku rreth 95% e tyre ofrohen tashmë në mënyrë elektronike përmes platformës e-Albania. Kjo platformë përbën një nga shtyllat kryesore të qeverisjes elektronike dhe ka mundësuar thjeshtimin e procedurave administrative, reduktimin e kohës së marrjes së shërbimeve dhe rritjen e transparencës institucionale. Gjatë këtij procesi janë integruar gradualisht edhe teknologji të avancuara si inteligjenca artificiale, machine learning, big data analytics dhe zgjidhje të tjera digjitale, të cilat synojnë përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të shërbimeve dhe automatizimin e proceseve administrative.

⁵ AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT- RAPORT VJETOR PËRMBLEDHËS 2025 chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2026/04/Raporti-Vjetor-AKSHI-2025-1.pdf

Në nivel institucional, çdo institucion publik ka zhvilluar sisteme elektronike të dedikuara sipas nevojave të tij funksionale, duke mundësuar digjitalizimin e proceseve të brendshme, uljen e kostove administrative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjithashtu janë krijuar sisteme të qendëruara dhe ndërinstucionale për menaxhimin e proceseve komplekse që kërkojnë ndërveprim ndërmjet disa institucioneve, duke rritur koordinimin dhe efikasitetin administrativ. Në këtë kuadër, AKSHI garanton funksionimin e pandërprerë të infrastrukturës digjitale 24/7, duke siguruar disponueshmëri dhe qëndrueshmëri të shërbimeve elektronike në çdo kohë.

Transformimi digjital është shoqëruar edhe me rezultate të matshme të konsiderueshme.

Sot **1,277** shërbime ose rreth 95% e të gjitha shërbimeve publike ofrohen online nëpërmjet portalit e-Albania i cili është shndërruar në pikën kryesore të ndërveprimit ndërmjet qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve publike, me rreth **3.5 milionë** përdorues të regjistruar.

Deri më sot, nëpërmjet e-Albania janë ofruar rreth **70 milionë** shërbime publike elektronike, ndërsa vetëm gjatë periudhës 2020–2026 janë realizuar rreth **65 milionë** shërbime online.

Në të njëjtën kohë, janë gjeneruar rreth **47 milionë** dokumente me vulë elektronike, prej të cilave **44 milionë** i përkasin periudhës 2020–2026.

Një zhvillim i rëndësishëm në këtë drejtim është edhe përdorimi i asistentit virtual “Diella”, nëpërmjet të cilit, që nga 17 prilli 2025, janë gjeneruar **13,919** dokumente me vulë elektronike.

Aktualisht, **63 regjistra elektronikë** janë të ndërlidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale në mënyrë të sigurt dhe të besueshme. 69% e fushave në formularët e aplikimit për shërbimet publike në e-Albania plotësohen automatikisht përmes komunikimit ndërmjet regjistrave elektronikë të institucioneve të ndryshme, duke thjeshtuar ndjeshëm procesin për qytetarët dhe bizneset.

Vetëm gjatë vitit 2025 janë kryer mbi **450 milionë** transaksione nepermjet Platformes Qeveritare te Nderveprimit, ndërsa në vitin 2026 janë regjistruar rreth **200 milionë** transaksione.

Transformimi digjital ka sjellë gjithashtu përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe administrative. Që nga viti 2017 vlerësohet se janë kursyer rreth **1,500 vite** dhe rreth **24 milionë euro** nga eliminimi i procedurave fizike dhe tarifave të lidhura me to. Nga këto, rreth **1,400 vite** dhe **20 milionë euro** kursime i përkasin periudhës 2020–2026.

Në Shqipëri, në kuadër të transformimit digjital të administratës publike dhe përdorimit të inteligjencës artificiale në shërbime, janë zhvilluar dhe pilotuar disa zgjidhje inovative që synojnë përmirësimin e ndërveprimit me qytetarët, rritjen e efikasitetit administrativ dhe reduktimin e barrës burokratike. Këto nisma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt përdorimit praktik të IA-së në sektorin publik, duke kaluar nga digjitalizimi klasik i shërbimeve drejt automatizimit dhe asistencës inteligjente.

Një nga elementet më të spikatura është përdorimi i asistencës virtuale të bazuar në inteligjencë artificiale, e njohur si “Diella”, e cila është konceptuar si një asistente virtuale me funksione orientuese dhe mbështetëse për qytetarët në aksesimin e shërbimeve publike. Qëllimi i kësaj zgjidhjeje është thjeshtimi i komunikimit me administratën, reduktimi i kohës së kërkimit të informacionit dhe minimizimi i ndërveprimeve të drejtpërdrejta që shpesh krijojnë vonesa dhe hapësira për burokraci. Në një kuptim më të gjerë, zgjidhje të tilla synojnë të standardizojnë përgjigjet administrative dhe të rrisin transparencën në ofrimin e informacionit publik.

Paralelisht, janë zhvilluar edhe platforma të tjera të bazuara në inteligjencë artificiale si “MIRA”, e cila synon të mbështesë proceset e analizës dhe ndërveprimit me të dhënat në shërbimet publike, duke ofruar asistencë inteligjente për përdoruesit dhe administratën në trajtimin e informacionit dhe proceseve

vendimmarrëse. Këto platforma synojnë të rrisin efikasitetin e brendshëm institucional dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve përmes automatizimit të detyrave rutinë dhe përpunimit më të shpejtë të informacionit.

Në sektorin e bujqësisë është zhvilluar gjithashtu asistenti digjital “Ylli”, i cili synon të ofrojë informacion dhe udhëzime për fermerët dhe subjektet bujqësore në lidhje me praktikatat bujqësore, skemat mbështetëse dhe shërbimet publike të lidhura me këtë sektor. Ky mjet synon të rrisë aksesin në informacion në zonat rurale, të përmirësojë përdorimin e skemave të mbështetjes dhe të kontribuojë në modernizimin e sektorit bujqësor përmes përdorimit të teknologjive të reja.

Këto platforma përfaqësojnë një fazë të re të zhvillimit të qeverisjes digjitale në Shqipëri, ku teknologjitë e inteligjencës artificiale nuk përdoren vetëm për digjitalizimin e shërbimeve ekzistuese, por edhe për krijimin e ndërfaqeve inteligjente që synojnë të përmirësojnë mënyrën se si qytetarët dhe bizneset ndërveprojnë me administratën publike.

Në një këndvështrim më teknik, këto zhvillime përfaqësojnë **gatishmërinë institucionale të Shqipërisë për të zhvilluar dhe zbatuar një kuadër rregullator për inteligjencën artificiale**, si dhe për të treguar se kapacitetet administrative dhe infrastrukturore janë tashmë në proces konsolidimi.

Në këtë drejtim, angazhimi i institucioneve publike në forume ndërkombëtare të fokusuar në inteligjencën artificiale dhe sistemet e informacionit të bazuara në teknologji të avancuara tregojnë një përfshirje aktive në debatet globale mbi qeverisjen e IA-së, sigurinë kibernetike dhe transformimin digjital të sektorit publik. Këto pjesëmarrje nuk kanë vetëm karakter informues, por shërbejnë edhe si mekanizma për përafrimin gradual me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare, përfshirë ato të Bashkimit Evropian, në lidhje me zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale.

Paralelisht, zbatimi i masave konkrete në fushën e infrastrukturës digjitale, veçanërisht në sektorin e arsimit, dëshmon për një nivel të avancuar të digjitalizimit institucional dhe për një bazë të konsoliduar teknike mbi të cilën mund të ndërtohen aplikacione dhe sisteme të inteligjencës artificiale në të ardhmen. Përmirësimi i aksesit në internet me shpejtësi të lartë në institucionet arsimore publike dhe zhvillimi i mjediseve digjitale të të nxëniet kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e aftësive digjitale të kapitalit njerëzor, i cili përbën një kusht thelbësor për adoptimin efektiv të teknologjive të IA-së.

Në këtë kuptim, këto zhvillime së bashku tregojnë se Shqipëria nuk ndodhet në një fazë fillestare të digjitalizimit, por në një fazë tranzicioni drejt përdorimit të teknologjive të avancuara dhe inteligjencës artificiale në funksione publike. Kjo krijon premisa të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin e një kuadri rregullator të dedikuar për IA-në, i cili të jetë në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe me standardet e Bashkimit Evropian, duke garantuar njëkohësisht përdorim të sigurt, etik dhe efikas të këtyre teknologjive në administratën publike dhe më gjerë.

Drejtoria e Inteligjencës Artificiale dhe Licencimit të Kriptomonedhave ka vijuar gjatë vitit 2025 zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kyçe që mbështesin ofrimin e shërbimeve publike më efikase, të digjitalizuara dhe të orientuara drejt qytetarit. Këto zhvillime kanë kontribuar në forcimin e përdorimit të teknologjive të inteligjencës artificiale në administratën publike dhe në përmirësimin e cilësisë së ndërveprimit me përdoruesit.

Më 28 dhjetor 2023, u lançua versioni i parë i asistentit virtual të e-Albania (versioni 1.0), duke shënjuar një shtesë novatore në portalin e shërbimeve publike të qeverisë shqiptare. Asistenti virtual është krijuar për të ofruar informacion dhe ndihmë për qytetarët në lidhje me përdorimin e shërbimeve publike të ofruara nga platforma. Mundësuar nga teknologjia e inteligjencës artificiale, asistenti automatizon përgjigjet dhe ofron udhëzime të shpejta për pyetje të zakonshme në lidhje me shërbimet e platformës, që do ta lehtësojë dhe thjeshtëzojë më shumë marrjen e 1271 shërbimeve elektronike, duke shkurtuar kohë dhe duke rritur cilësinë e shërbimit.

Viti 2025 shënon një fazë të konsolidimit dhe zgjerimit të zgjidhjeve të inteligjencës artificiale në sektorin publik. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve ekzistuese, shtimit të funksionaliteteve të reja dhe mbështetjes së proceseve strategjike, përfshirë edhe ato të lidhura me integrimin evropian, është arritur rritje e ndjeshme e performancës, përdorimit dhe efektivitetit të platformave ekzistuese. Në qendër të këtyre zhvillimeve ka vijuar të qëndrojë Asistenti Virtual në platformën e-Albania, i cili, përmes versioneve të përmirësuara, ka ofruar shërbime më inteligjente, më të personalizuar dhe gjithnjë e më proaktive, ndërsa sistemet e tjera kanë kontribuar në përmirësimin e proceseve ligjore, fiskale dhe administrative.

Në aspektin e promovimit të risive dhe aktiviteteve, Sektori i Promovimit të e-Gov ka pasur një angazhim të rëndësishëm në publikimin e zhvillimeve kryesore në fushën e teknologjisë dhe qeverisjes digjitale. Ndër to, një rëndësi disaditore i është dhënë promovimit të Konferencës së mbështetur nga World Bank Albania për fuqizimin e Inteligjencës Artificiale në shërbimet publike në Shqipëri, e cila shërbeu si një platformë e rëndësishme bashkëpunimi ndërmjet institucioneve vendase, partnerëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve të teknologjisë, duke reflektuar mbi transformimin digjital të vendit dhe rolin e Inteligjencës Artificiale në këtë proces.

Në kuadër të zhvillimeve kryesore të vitit 2025, Asistenti Virtual “Diella” është përmirësuar në versionin 3.0, duke sjellë avancime të rëndësishme në ndërveprimin me qytetarët. Ndër risitë kryesore përfshihet implementimi i shërbimeve proaktive, të cilat mundësojnë gjenerimin dhe ofrimin automatik të dokumenteve në varësi të nevojave të përdoruesve. Gjatë këtij viti janë regjistruar mbi 1,431,119 ndërveprime dhe janë gjeneruar automatikisht 61,042 dokumente, duke reflektuar rritje të përdorimit dhe përmirësim të ndjeshëm të eksperiencës së përdoruesit.

Paralelisht, sistemi i Mbivendosjes Ligjore është zhvilluar më tej përmes zgjerimit të funksionaliteteve të tij, duke forcuar kapacitetet për analizën dhe menaxhimin e akteve ligjore. Ndër zhvillimet kryesore përfshihen regjistrimi dhe administrimi i akteve ligjore, menaxhimi i analizave përkatëse, si dhe zhvillimi i raporteve analitike përmes platformave të inteligjencës së biznesit, me qëllim mbështetjen e proceseve të monitorimit dhe vendimmarrjes institucionale.

Në fushën e integritetit evropian, është vijuar puna për forcimin e sistemit të harmonizimit ligjor me acquis të Bashkimit Evropian, përmes integritetit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2025–2027 dhe mbështetjes teknike për institucionet përgjegjëse në procesin e përafritimit ligjor. Ky sistem ka kontribuar në përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe në rritjen e efikasitetit të procesit të transpozimit të legjislatcionit evropian.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 është vijuar me mirëmbajtjen dhe optimizimin e sistemit të detektimit të anomalive në fiskalizim, i cili ka siguruar një analizë më të avancuar të të dhënave fiskale dhe ka kontribuar në rritjen e kontrollit dhe integritetit të sistemit fiskal. Po ashtu, mjeti i përkthimit automatik të dokumenteve zyrtare është përmirësuar më tej, duke garantuar saktësi të lartë, stabilitet dhe ruajtje të plotë të formatimit original të dokumenteve gjatë procesit të përkthimit.

Projektet që janë pjesë e paketës së marrëveshjes me Bankën Botërore përbëjnë një komponent të rëndësishëm të reformave në fushën e digjitalizimit dhe modernizimit të administratës publike, duke synuar rritjen e eficiencës, transparencës dhe përdorimit të teknologjive të avancuara në proceset shtetërore. Në këtë kuadër përfshihen nisja të tilla si ngritja dhe zhvillimi i Qendrave Rinore të Inovacionit, të cilat synojnë forcimin e aftësive digjitale dhe nxitjen e inovacionit tek të rinjtë, si dhe përmirësimi i sistemeve ekzistuese të menaxhimit financiar publik (AFMIS), me qëllim rritjen e automatizimit, saktësisë dhe kontrollit në administrimin e financave publike.

Po ashtu, një komponent i rëndësishëm i kësaj pakete është përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik përmes integritetit të teknologjive të avancuara të inteligjencës artificiale dhe proceseve të automatizuara (RPA – Robotic Process Automation), me synim rritjen e transparencës, reduktimin e ndërhyrjes manuale në procese dhe minimizimin e riskut të gabimeve apo praktikave joefikase. Këto ndërhyrje kontribuojnë në

modernizimin e infrastrukturës dixhitale të shtetit dhe në përafrimin me standardet ndërkombëtare të verësive së mirë dhe digjitalizimit të shërbimeve publike.

Gjithashtu, është finalizuar Strategjia Kombëtare e Inteligjencës Artificiale e Shqipërisë 2025–2030, e cila, pas përmbylljes së fazës së konsultimit publik, është përcjellë pranë Kryeministrit për vijimin e procedurave të mëtejshme të shqyrtimit dhe miratimit. Ky dokument përbën një kuadër të rëndësishëm strategjik për orientimin e zhvillimit dhe përdorimit të inteligjencës artificiale në sektorin publik dhe privat, duke synuar përcaktimin e prioritetëve kombëtarë, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknologjike, si dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, etik dhe të qëndrueshëm për aplikimin e teknologjive të avancuara në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe procesin e integritit evropian.

Në fushën e sigurisë kibernetike, zbulimi i kërcënimeve është forcuar përmes rritjes së aftësive të korelimit të indikatorëve të komprometimit dhe përdorimit të analizës së avancuar të sjelljes për identifikimin e aktivitetëve të dyshimta, përfshirë ato të shpërndara në kohë ose të fshehura në mënyrë që të shmangin mekanizmat tradicionalë të detektimit. Kjo qasje ka mundësuar rritjen e ndjeshmërisë së sistemeve ndaj teknikave të sofistikuar të evazionit dhe ndaj skenarëve të sulmeve të tipit “low-and-slow”, duke përmirësuar ndjeshëm kapacitetin për identifikimin e hershëm të rreziqeve kibernetike.

Në këtë kuadër, sistemet e inteligjencës mbi kërcënimet kanë luajtur një rol qendror në agregimin, korelimin dhe analizimin e të dhënave të lidhura me incidente dhe sulme kibernetike, me qëllim pasurimin e bazës së njohurive operacionale dhe shpërndarjen e informacionit të strukturuar drejt platformave të tjera të sigurisë. Ky integrim ka forcuar koordinimin ndërmjet mekanizmave të ndryshëm të mbrojtjes dhe ka rritur kapacitetin për reagim më të shpejtë dhe më të saktë ndaj incidentëve.

Paralelisht, menaxhimi i vulnerabiliteteve është zhvilluar mbi bazën e një qasjeje të strukturuar të vlerësimit dhe priorizimit të riskut, duke kombinuar nivelin e ekspozimit teknik me kontekstin operacional dhe rëndësinë kritike të aseteve të informacionit. Kjo metodologji ka kontribuar në rritjen e efikasitetit të trajtimit të dobësive të identifikuara dhe në reduktimin e sipërfaqes së mundshme të sulmit. Në mbështetje të këtij procesi janë përdorur gjithashtu mekanizma monitorimi të reputacionit dhe vlerësimi të ekspozimit ndaj aktivitetëve të rrezikshme në rrjet, duke forcuar më tej qëndrueshmërinë e përgjithshme të infrastrukturës digjitale shtetërore.

Në nëntor 2025 është nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet AKSHI-t, kompanisë Oracle dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për projektin “Oracle Government Data Intelligence for Agriculture system”, i cili do të integrojë inteligjencën artificiale në sektorin bujqësor të Shqipërisë, duke shfrytëzuar të dhëna historike, meteorologjike dhe satelitore për të parashikuar rendimentet e kulturave bujqësore, për të optimizuar përdorimin e burimeve, për të mbështetur bujqësinë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të rritur efektivitetin e skemave të subvencioneve dhe granteve. Sektori ka kontribuar në koordinimin e plotë të këtij procesi, që nga nisja e diskutimeve deri në nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit.

Shqipëria u bë pjesë e Bordit të EuroHPC JU në qershor 2025. Përmes anëtarësimit në EuroHPC Joint Undertaking, iniciativa më e avancuar e Bashkimit Evropian për superkompjuterët, vendi siguron akses të drejtpërdrejtë në kapacitetet më të larta llogaritëse në kontinent. Sektori ka kontribuar në procesin e aplikimit dhe anëtarësimit në këtë bord. Shqipëria ka nisur procesin e anëtarësimit në Organizatën për Bashkëpunim Digjital (DCO) nëpërmjet AKSHI-t, një organizatë ndërqeveritare që synon përshtetimin e zhvillimit të ekonomisë digjitale përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimit të praktikave dhe nismave konkrete në fusha si inovacioni, sipërmarrja dhe inteligjenca artificiale. Ky anëtarësim do të mundësojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në nisma konkrete, partneritete strategjike dhe programe për ndërtimin e kapaciteteve në ekonominë digjitale.

Në këtë kuadër vlen të përmendet edhe Programi i Evropës Digjitale (Digital Europe Programme 2021–2027), i cili është një instrument financiar dhe strategjik i Bashkimit Evropian, i krijuar me qëllim mbështetjen dhe përshtetimin e transformimit digjital në shtetet anëtare dhe vendet partnere, përmes rritjes

së përdorimit të teknologjive digjitale nga bizneset, qytetarët dhe administratat publike. Ky program është miratuar me Rregulloren (BE) 2021/694 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2021, dhe përbën një nga shtyllat kryesore të politikave të BE-së për ndërtimin e një ekonomie dhe shoqërie të bazuar në të dhëna dhe teknologji të avancuara.

Në thelb, programi synon të forcojë kapacitetet digjitale të Bashkimit Evropian në disa fusha prioritare strategjike, duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturave të avancuara digjitale, rritjen e përdorimit të inteligjencës artificiale, forcimin e kapaciteteve në fushën e të dhënave dhe cloud computing, si dhe përmirësimin e aftësive digjitale të forcës punëtore dhe administratës publike. Në mënyrë të veçantë, një nga objektivat kryesorë të programit është “Inteligjenca artificiale, të dhënat dhe cloud”, i cili synon nxitjen e zhvillimit dhe përdorimit të zgjidhjeve të IA-së në sektorët publikë dhe privatë, si dhe krijimin e infrastrukturave të përbashkëta evropiane për përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave.

Në këtë kontekst, Programi i Evropës Digjitale përbën një referencë të rëndësishme edhe për vendet kandidatë për anëtarësim në BE, përfshirë Shqipërinë, pasi orienton politikën kombëtare drejt përafrimit me standardet evropiane në fushën e transformimit digjital dhe inteligjencës artificiale. Ai shërben si kuadër mbështetës për zhvillimin e kapaciteteve institucionale, teknologjike dhe rregullatore, duke krijuar bazën për integrimin e mëtejshëm të teknologjive të avancuara në administratën publike dhe në ekonominë digjitale.

Shqipëria është bërë pjesë e Programit të Evropës Digjitale (2021 – 2027), me nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Digjital të Evropës (2021-2027). Ligji nr. 87/2023 “Mbi ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Bashkimit Evropian nga ana tjetër për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Digjital të Evropës (2021-2027) është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 171, datë 22.11.2023, dhe ka hyrë në fuqi më 7 dhjetor 2023. Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes të gjitha entitetet ligjore të Shqipërisë, si nga sektori publik, sektori privat dhe nga akademia kanë të drejtë të marrin pjesë në thirrjet e hapura nga BE në kuadër të këtij programi. Për më shumë informacion për Programin Digjital të BE-së (2021-2027). Programi i Evropës Digjitale (2021–2027) është një instrument i krijuar dhe financuar nga Bashkimi Evropian me qëllim mbështetjen e transformimit digjital dhe rritjen e përdorimit të teknologjive digjitale nga bizneset, qytetarët dhe administratat publike. Shqipëria është bërë pjesë e këtij programi pas nënshkrimit dhe ratifikimit të marrëveshjes për pjesëmarrjen në Programin Digjital të Evropës më 7 dhjetor 2023. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, të gjitha entitetet ligjore në Shqipëri, nga sektori publik, sektori privat dhe akademia, kanë të drejtë të aplikojnë dhe të marrin pjesë në thirrjet e hapura nga BE në kuadër të këtij programi. Në vijim të ftesës së Komisionit Evropian, në kuadër të zbatimit të Programit të Evropës Digjitale (DEP), AKSHI (përfaqësuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit dhe Koordinimit të Fondeve të BE-së), si një nga institucionet përfaqësues dhe përgjegjës për zbatimin e këtij programi në Shqipëri, mori pjesë në konferencën “Perspektivat e ardhshme të investimeve digjitale në BE”, e zhvilluar në Aalborg, Danimarkë, në datat 2–3 korrik 2025.

Konferenca u fokusua në diskutimin e zbatimit dhe perspektivave të mëtejshme të Programit të Evropës Digjitale (2021–2027), duke trajtuar politikën, investimet dhe bashkëpunimet në fushat e teknologjive digjitale, përfshirë inteligjencën artificiale (AI), të dhënat dhe cloud, si dhe duke krijuar një platformë dialogu ndërmjet përfaqësuesve të biznesit, akademisë dhe politikëbërjes për përcaktimin e prioritetëve të transformimit digjital në nivel evropian. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si institucione bashkëdrejtuese të procesit të integritimit në fushën digjitale, janë duke ndjekur aktivitetet 48 në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin Digjital të Bashkimit Evropian (DEP), si shtet i asociuar me programin, edhe pa qenë anëtar i BE-së. Referuar kësaj agjende, është kërkuar të identifikohen qendrat e inovacionit digjital në vend, që po kontribuojnë në këtë fushë, për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në Programin Digjital të Bashkimit Evropian (DEP). Gjatë vitit 2024, është hapur thirrja për të identifikuar qendrat EDIH, të cilat kanë kaluar në një proces të gjatë aplikimi, përzgjedhjeje dhe janë në fazën e implementimit.

Aktualisht janë fituar dy nga projektet e aplikuar:

- EDIH Projekti AI4DigiT – Artificial Intelligence for Digital Transformation in Albania Innovation Hub synon krijimin e një Qendre Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) për inteligjencën artificiale dhe transformimin digjital në Shqipëri, me fokus të veçantë sektorin e turizmit dhe inovacionin ndërsektorial. Konsorciumi i projektit bazohet në modelin triple helix, duke bashkuar akademinë, sektorin publik dhe biznesin. Partnerët përfshijnë Universitetin e Tiranës (UT) si koordinator i projektit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI/NAIS) si autoritet publik për ICT, Këshillin Shqiptar për Teknologji dhe Inovacion (ACTI) që përfaqëson sektorin e teknologjisë dhe inovacionit, si dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT) që siguron përfshirjen dhe përfitim të NVMve. Aktivitetet kryesore të projektit janë ndërtuar mbi katër shtyllat e EDIH: rrjetëzim, aftësi, “Test Before Invest” dhe akses në financë. Këto përfshijnë krijimin e një AI Help Desk për NVM-të dhe institucionet publike, vlerësimin e maturisë digjitale, shërbime për përputhshmëri me AI Act dhe GDPR, zhvillimin e udhërrëfyesve të personalizuar për adoptimin e IA-së, trajnime hyrëse dhe të avancuara, aktivitete informuese, si dhe lidhjen me infrastruktura dhe mundësi financimi në nivel evropian. Implementimi i projektit parashikohet të zgjasë 36 muaj.
- NCC Albania Shqipëria i është bashkuar aplikimit për projektin NCC ((National Competence Centres for High Performance Computing) dhe është shpallur fitues, aplikim i cili ka si institucion drejtues (Lead) University of Stuttgart (Gjermani). NCC Albania (Techspace-AKSHI) do të shërbejë si qendra kombëtare për High-Performance Computing (HPC), High-Performance Data Analytics (HPDA) dhe Inteligjencë Artificiale (AI), duke mbështetur industrinë, akademinë dhe administratën publike në adoptimin e teknologjive të avancuara kompjuterike. Aktivitetet kryesore përfshijnë ofrimin e konsulentëve teknike për optimizimin e kodeve dhe integrimin e proceseve të AI dhe HPDA; zhvillimin e Prove-of-Concepts (PoC) për të demonstruar vlerën konkrete të HPC në biznes; dhe trajnimet kombëtare për zhvillimin e aftësive teknike në bashkëpunim me CASTIEL3, EVITA dhe EUMaster4HPC. Për NCC Albania, anëtarët e konsorciumit janë: • AKSHI (Koordinator) • Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (Partner)

Në aspektin institucional dhe të koordinimit, Shqipëria ka forcuar bashkëpunimin me partnerë ndërkombëtarë në fushën e digjitalizimit dhe teknologjive të reja, përfshirë **Bashkimin Evropian**, përmes mekanizmave të asistencës dhe programeve të financuara nga BE, si dhe përmes pjesëmarrjes në iniciativat rajonale të ekonomisë digjitale në kuadër të **Procesit të Berlinit** dhe **tregut të përbashkët rajonal (Common Regional Market)**, ku digjitalizimi dhe inovacioni teknologjik janë fusha prioritare.

Po ashtu, Shqipëria është përfshirë në programe ndërkombëtare të mbështetjes për transformimin digjital dhe qeverisjen elektronike, të cilat kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe teknike për përdorimin e teknologjive të avancuara, përfshirë komponentë të inteligjencës artificiale në analizën e të dhënave dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Gjatë vitit 2025 u ratifikua Marrëveshja Kuadër e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë të Veprimit për Ofrimin e Shërbimeve të Përqendruara dhe Gjithëpërfshirëse për Përdoruesit, përmes Ligjit nr. 45/2025. Objektivi kryesor i Programit mbetet rritja e aksesit të barabartë dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve digjitale të përzgjedhura. Financimi Shtesë zgjeron Programin ekzistues duke adresuar prioritete të reja strategjike të reformës së sektorit publik në Shqipëri dhe duke futur dy tregues të rinj të lidhur me disbursimin, me qëllim nxitjen e arritjes së rezultateve kyçe. 50 Fokusi i Financimit Shtesë përqendrohet në përmirësimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të pushtetit vendor, në projektimin dhe zbatimin e një platforme të re të prokurimit të bazuar në Inteligjencë Artificiale, si dhe në përmirësimin dhe zbatimin e Sistemit të Integruar të Menaxhimit Financiar (AFMIS) në nivel qendror dhe vendor. Rezultatet e synuara përfshijnë ridizenjimin dhe digjitalizimin e të të shërbimeve prioritare vendore, prej të cilave dy të lidhura me parandalimin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, rritjen me të paktën 22% të përdorimit të shërbimeve digjitale vendore nga qytetarët, si dhe përdorimin nga të paktën 50% e bashkive të proceseve të përmirësuara të menaxhimit financiar përmes AFMIS-it të ri. Janë lidhur marrëveshje mirëkuptimi me ministritë e linjës dhe agjencitë përkatëse për vijimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të projektit, konkretisht me Ministrinë e Financave, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Marrëveshja AKSHI – NIA dhe krijimi i IAC Një zhvillim i rëndësishëm gjatë vitit është:

• 3 Dhjetor 2024 – Nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet AKSHI dhe NIA (Kore e Jugut) Kohëzgjatja: 4 vite Në kuadër të kësaj marrëveshjeje parashikohet krijimi i Qendrës së Aksesit në Informacion (IAC) në ambientet e TechSpace, e cila përfshin: Sallë trajnimi digjital, Sallë videokonference, Qendër për Inteligjencë Artificiale.

Në aspektin e përafrimit rregullator, administrata ka nisur procesin e harmonizimit gradual me **kuadrin e Bashkimit Evropian për inteligjencën artificiale (AI Act)** dhe dokumentet shoqëruese të tij, duke krijuar bazat për një qasje të strukturuar ndaj menaxhimit të rreziqeve, etikës dhe përdorimit të përgjegjshëm të IA-së në sektorin publik dhe privat.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale dhe rritjes së aftësive teknike në funksion të procesit të integritimit evropian, gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh trajnimi, workshop-e dhe ushtrimesh praktike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto aktivitete kanë synuar rritjen e njohurive dhe aftësive të administratës publike në përdorimin e instrumenteve digjitale, përmirësimin e proceseve të koordinimit ndërinstytucional dhe rritjen e efikasitetit në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar trajnime të dedikuara për përdorimin e modulit të inteligjencës artificiale në Platformën për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA), të organizuara në dy faza gjatë periudhave 30.01.2025–10.02.2025 dhe 04.03.2025–07.03.2025, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e proceseve të përkthimit, analizës dhe përafrimit të legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian. Këto zhvillime kanë rritur ndjeshëm efikasitetin e punës administrative dhe kanë forcuar përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale në funksion të proceseve të integritimit.

Paralelisht, është marrë pjesë në workshop-in për prezantimin e Paketës së Instrumenteve për angazhimin me palët e interesit (PPIE Toolbox), i cili ka pasur si qëllim përmirësimin e dialogut institucional me grupet e interesit dhe rritjen e transparencës në proceset e politikëbërjes. Gjithashtu, është zhvilluar pjesëmarrje në workshop-et e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), të fokusuara në forcimin e mekanizmave të konsultimit publik dhe raportimit në kuadër të procesit të integritimit.

Në funksion të përgatitjes për procesin e negociatave me Bashkimin Evropian, është marrë pjesë edhe në ushtrimin simulues (Mock Exercise) për Nënkomitetin “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”, si dhe në vetë mbledhjen e këtij nënkomiteti të zhvilluar në Bruksel më 24.04.2025. Këto angazhime kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale për raportim, negociim dhe koordinim në kuadër të strukturave të integritimit evropian, veçanërisht në fushat që lidhen drejtpërdrejt me inovacionin dhe shoqërinë e informacionit.⁶

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

⁶ AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT- RAPORT VJETOR PËRMBLEDHËS 2025 chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2026/04/Raporti-Vjetor-AKSHI-2025-1.pdf

Objektivi i përgjithshëm i politikës është: 'Krijimi i një kuadri ligjor kombëtar gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar me Rregulloren (BE) 2024/1689 (EU AI Act), që garanton mbrojtje efektive të shëndetit, sigurisë, të drejtave themelore, demokracisë dhe shtetit të së drejtës nga rreziqet e sistemeve të inteligjencës artificiale, dhe njëkohësisht krijon kushte mbështetëse për zhvillimin dhe përdorimin e përgjegjshëm e inovativ të IA-së në ekonominë dhe administratën shqiptare.'

Ky objektivi i përgjithshëm zbërthehet në disa objektiva specifike të matshëm e të kufizuar në kohë (kriteret SMART), si vijon:

1. Krijimi dhe funksionalizimi i plotë i autoriteteve kompetente (Struktura e IA-së/AKSHI, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Njoftues) brenda vitit 2028.
2. Regjistrimi i sistemeve IA me rrezik të lartë në regjistrin kombëtar, me synim afatgjatë 100% mbulim brenda vitit 2028.
3. Sigurimi që deri në fund të vitit 2028 të paktën 90% e sistemeve të inteligjencës artificiale me rrezik të lartë të identifikuar në sektorin publik dhe privat të kenë përmbushur kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për menaxhimin e riskut, transparencën, dokumentimin teknik dhe mbikëqyrjen njerëzore.
4. Sigurimi i periudhave tranzitore proporcionale (12 muaj për sistemet me rrezik të lartë, 24 muaj për sistemet ekzistuese në përgjithësi) për të lejuar adaptim të arsyeshëm nga operatorët ekonomikë.
5. Operacionalizimi i sandbox-it rregullator për IA, me synim pjesëmarrjen e 15-20 NVM-ve/start-up-eve brenda vitit 2028.
6. Trajnimi i personelit të autoriteteve kompetente dhe institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e ligjit, me synim që deri në fund të vitit 2028 të paktën 200 punonjës publikë të kenë përfunduar programe të specializuara mbi qeverisjen, mbikëqyrjen dhe përdorimin e sigurt të inteligjencës artificiale.
7. Sigurimi që deri në fund të vitit 2028 të gjitha institucionet publike që përdorin sisteme IA me ndikim në vendimmarrje administrative të publikojnë informacion bazë mbi përdorimin e tyre, përfshirë qëllimin, kategorinë e sistemit dhe masat e mbikëqyrjes njerëzore.
8. Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave për trajtimin e ankesave dhe shqyrtimin e rasteve që lidhen me përdorimin e sistemeve të IA-së, me synim që deri në fund të vitit 2028 të gjitha ankesat e regjistruara të trajtohen sipas procedurave të përcaktuara ligjërisht dhe brenda afateve përkatëse.
9. Mbështetja e zhvillimit dhe përdorimit të sistemeve të inteligjencës artificiale në institucionet publike në përputhje me kërkesat ligjore, me synim që deri në fund të vitit 2028 të paktën 10 institucione publike të kenë implementuar ose pilotuar zgjidhje IA.

Lidhja me dokumentet strategjike të qeverisë: Këta objektiva specifike nuk janë të izoluar, por shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në: (a) Strategjinë Ndërsektoriale për Axiendën Dixhitale të Shqipërisë 2022-2026, e cila parashikon shprehimisht hartimin e kuadrit ligjor për IA-në si masë e Planit të Veprimit në shtyllën e qeverisjes dixhitale dhe inovacionit;

(b) Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024-2026, në kuadër të Kapitullit 10 (Shoqëria e informacionit dhe media) dhe Kapitullit 28 (Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit), ku harmonizimi me EU AI Act-in përbën një masë konkrete legjislative të planifikuar;

(c) Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022-2030, në shtyllën e qeverisjes së mirë dhe transformimit dixhital të shtetit; dhe

(d) Programin e Qeverisë 2021-2025, kapitulli 'Shqipëria Dixhitale', i cili thekson rolin e teknologjive të reja në modernizimin e shërbimeve publike, duke e bërë të domosdoshme që ky modernizim të shoqërohet me garanci ligjore përkatëse për qytetarët.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*

- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Në vijim të paraqitjes së përmbledhur në Pjesën 1, kjo seksion ofron një përshkrim më të detajuar teknik të secilit prej tre opsioneve të shqyrtuara, duke specifikuar elementët konkretë rregullatorë që do të zbatoheshin (ose jo) nën secilin opsion.

OPSIONI 0 – STATUS QUO.

Nuk parashikohet të ndërmerret asnjë nismë rregullatore apo jorregullatore duke pritur që situata të vetërregullohet. Sistemet IA në Shqipëri do të vazhdojnë të operojnë nën kuadrin ekzistues: Ligji nr. 124/2024 'Për mbrojtjen e të dhënave personale' (zbatueshëm vetëm për përpunimin e të dhënave personale, jo për sistemin IA si të tillë); legjislacioni i përgjithshëm për mbrojtjen e konsumatorit (zbatueshëm vetëm te produktet/shërbimet me konsumatorë fundorë, dhe vetëm për dëme/defekte të dukshme, jo për 'paragjykim algoritmik'); dhe legjislacioni për sigurinë e produkteve (zbatueshëm vetëm kur IA është komponent sigurie i një produkti tashmë të rregulluar, p.sh. makineri).

Ndikimi: Asnjë organ shtetëror nuk ka mandat specifik për të mbikëqyrur sistemet IA si kategori e veçantë; asnjë praktikë e veçantë IA (scoring social, manipulim subliminal etj.) nuk është e ndaluar shprehimisht; asnjë detyrim transparence specifike për chatbot-ë apo përmbajtje deep-fake; pa regjistër kombëtar të sistemeve IA; pa sandbox rregullator.

Ky opsion nuk paraqet kosto të shtuar, por shkakton:

- boshllëk rregullator;
- mungesë mbikëqyrjeje dhe përgjegjshmërie;
- rreziqe për të drejtat themelore dhe konsumatorët;
- pasiguri juridike për bizneset;
- vështirësi në integrimin me tregun e BE-së;
- humbje mundësish për inovacion të kontrolluar dhe të sigurt.

OPSIONI 1 – Jorregullator

AKSHI, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, do të hartojë dhe publikojë udhëzime e kode sjelljeje vullnetare për ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve IA (analoge me atë që neni 95 i projektligjit parashikon si masë plotësuese vullnetare, por pa miratimin e ligjit bazë). Këto udhëzime mund të mbulojnë: praktika të mira për menaxhimin e riskut; vetëdeklarimin vullnetar të sistemeve IA me rrezik potencialisht të lartë; dhe parime etike të zhvillimit të IA-së (transparencë, drejtësi, llogaridhënie).

Ndikime: Asnjë ndalim ligjor detyrues i praktikave me rrezik të papranueshëm – ofruesit e të tilla sistemesh thjesht 'inkurajohen' të mos i përdorin, pa pasoja juridike; asnjë autoritet i ri mbikëqyrës me kompetenca ekzekutive (mund të krijohet vetëm një 'pikë kontakti' këshillimore brenda AKSHI-t, pa kompetenca sanksionuese); pajtueshmëria mbetet tërësisht vullnetare, prandaj nivel i ulët adoptimi pritet nga operatorët me kosto më të lartë konformiteti dhe stimuj më të dobët.

Për më tepër, ky opsion nuk do të siguronte përafrimin e plotë me kërkesat e Rregullores (BE) 2024/1689 (AI Act), pasi elementet thelbësore të saj, si klasifikimi i sistemeve sipas nivelit të rrezikut, detyrimet për sistemet me rrezik të lartë, procedurat e vlerësimit të konformitetit, mbikëqyrja e tregut, regjistrimi i sistemeve dhe regjimi sanksionues, kërkojnë bazë ligjore të posaçme. Si rrjedhojë, Shqipëria do të vijonte të kishte boshllëqe të konsiderueshme në procesin e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Gjithashtu, mungesa e një kuadri të detyrueshëm do të krijonte pasiguri juridike për zhvilluesit, ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve të inteligjencës artificiale, pasi standardet e sjelljes do të kishin karakter rekomandues dhe jo detyrues. Kjo mund të çonte në zbatim jo të njëtrajtshëm të praktikave të sigurisë dhe

transparencës, si dhe në trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve që zgjedhin të respektojnë vullnetarisht udhëzimet dhe atyre që nuk i zbatojnë ato.

Megjithëse ky opsion do të mundësonte promovimin e praktikave të mira dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale, efektiviteti i tij do të ishte i kufizuar për shkak të mungesës së detyrueshmërisë juridike. Udhëzimet dhe kodet e sjelljes nuk do të krijonin detyrime ligjore të zbatueshme dhe as mekanizma formalë për monitorimin e respektimit të tyre, duke e lënë nivelin e pajtueshmërisë në varësi të vullnetit të operatorëve ekonomikë.

OPSIONI 2 – LIGJ I HARMONIZUAR PLOTËSISHT ME EU AI ACT (I PREFERUAR)

Ky opsion konsiston në miratimin e projektligjit të plotë “Për Inteligjencën Artificiale”, i cili transponon në mënyrë të plotë arkitekturën rregullatore të Rregullores (BE) 2024/1689 (EU AI Act). Projektligji përcakton qëllimin, fushën e zbatimit dhe përkufizimet kryesore, si dhe vendos një qasje të bazuar në nivelin e rrezikut të sistemeve të inteligjencës artificiale. Ai parashikon ndalimin e praktikave të inteligjencës artificiale që konsiderohen me rrezik të papranueshëm për të drejtat themelore, sigurinë dhe interesin publik, ndërsa vendos kërkesa të detajuara për sistemet me rrezik të lartë, përfshirë menaxhimin e riskut, cilësinë e të dhënave, dokumentimin teknik, mbikëqyrjen njerëzore dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

Projektligji do të parashikojë gjithashtu detyrime specifike transparence për kategori të caktuara sistemesh të inteligjencës artificiale, rregulla për modelet e inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm (GPAI), mekanizma të mbikëqyrjes së tregut dhe monitorimit të zbatimit të ligjit, si dhe krijimin e autoriteteve kompetente përgjegjëse për mbikëqyrjen, kontrollin dhe zbatimin e dispozitave të tij. Krahas kësaj, ai përfshin masa mbështetëse për inovacionin, si krijimi i sandbox-eve rregullatore për testimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në kushte të kontrolluara, si dhe parashikon kode sjelljeje, procedura administrative dhe masa sanksionuese në rast të mosrespektimit të kërkesave ligjore.

Ndikimet: Ky opsion krijon një kuadër ligjor të plotë dhe detyruës për zhvillimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në Shqipëri. Ai siguron ndalimin e praktikave me rrezik të papranueshëm, vendos kërkesa proporcionale sipas nivelit të rrezikut, krijon autoritete kompetente me kompetenca mbikëqyrëse dhe sanksionuese, mundëson ngritjen e regjistrit kombëtar të sistemeve të inteligjencës artificiale dhe krijon mekanizma të posaçëm për mbështetjen e inovacionit. Në të njëjtën kohë, ai siguron harmonizim të plotë me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë dhe krijon siguri juridike për institucionet publike, bizneset dhe qytetarët.

Ky opsion ofron nivelin më të lartë të sigurisë juridike dhe mbrojtjes së interesit publik, pasi krijon një kuadër të plotë dhe të detyrueshëm për zhvillimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale. Ai adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë boshllëqet ekzistuese rregullatore, vendos rregulla të qarta për sistemet sipas nivelit të rrezikut, krijon mekanizma mbikëqyrjeje dhe zbatimi, si dhe garanton mbrojtje më të mirë të të drejtave themelore, sigurisë dhe transparencës. Gjithashtu, siguron harmonizim të plotë me Rregulloren (BE) 2024/1689 (EU AI Act), duke mbështetur procesin e integritetit evropian, duke rritur besimin e qytetarëve dhe investitorëve dhe duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e inovacionit përmes instrumenteve si sandbox-et rregullatore.

Zbatimi i këtij opsioni shoqërohet me kosto administrative dhe financiare më të larta krahasuar me alternativat e tjera, si për institucionet publike ashtu edhe për operatorët ekonomikë. Krijimi i autoriteteve kompetente, ngritja e mekanizmave të mbikëqyrjes, regjistrave dhe procedurave të konformitetit kërkon burime njerëzore, teknike dhe financiare shtesë. Për bizneset, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mund të krijohen detyrime të reja për dokumentim, transparencë dhe vlerësim të riskut, të cilat mund të rrisin kostot e pajtueshmërisë në afat të shkurtër. Gjithashtu, zbatimi efektiv i kuadrit të ri kërkon

ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve administrative dhe teknike për të garantuar mbikëqyrje dhe zbatim të qëndrueshëm të dispozitave ligjore.

OPSIONI 3 – HARMONIZIM I PJESSHËM PËRMES NDRYSHIMEVE NË LEGJISLACIONIN EKZISTUES

Ky opsion konsiston në mosmiratimin e një ligji të posaçëm për inteligjencën artificiale, por në ndërmarrjen e ndryshimeve dhe shtesave në legjislacionin ekzistues sektorial, me qëllim adresimin e disa aspekteve të përdorimit të inteligjencës artificiale dhe përafrimit të pjesshëm me kërkesat e Rregullores (BE) 2024/1689 (EU AI Act). Ndryshimet do të mund të përfshinin, ndër të tjera, ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, legjislacionin për sigurinë e produkteve, mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë kibernetike, komunikimet elektronike dhe procedurat administrative, duke futur dispozita që lidhen me transparencën algoritmike, përdorimin e sistemeve të automatizuara në vendimmarrje, mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe detyrime të kufizuara për ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Ky opsion do të mundësonte adresimin e disa prej problematikave më urgjente pa krijuar një regjim të ri tërësisht të pavarur rregullator. Megjithatë, ai nuk do të krijonte një kuadër të unifikuar për inteligjencën artificiale, nuk do të mundësonte transpozimin e plotë të qasjes së bazuar në risk të AI Act, nuk do të parashikonte një sistem të dedikuar të mbikëqyrjes së tregut, regjistrimin e sistemeve me rrezik të lartë, sandbox-et rregullatore apo rregullimin e plotë të modeleve të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm.

Ky opsion ka kosto më të ulëta financiare dhe administrative sesa miratimi i një ligji të ri të plotë, pasi mbështetet në strukturat ekzistuese institucionale dhe legjislative. Ai mund të zbatohet më shpejt dhe të mundësojë adresimin gradual të disa rreziqeve të lidhura me inteligjencën artificiale.

Ndryshimet e shpërndara në disa ligje do të krijojnë një kuadër të fragmentuar dhe potencialisht jo koherent, duke vështirësuar zbatimin dhe interpretimin e rregullave nga autoritetet dhe operatorët ekonomikë. Gjithashtu, ky opsion nuk do të siguronte harmonizim të plotë me AI Act dhe do të linte të paadresuara një numër të konsiderueshëm kërkesash dhe mekanizmash të parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, ai do të kontribuonte vetëm pjesërisht në arritjen e objektivave të politikës dhe në procesin e përafrimit me acquis të BE-së.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*

- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Ky seksion paraqet vlerësimin e detajuar të ndikimeve të Opsionit 2 (i preferuar) krahasuar me bazën (Opsioni 0), në përputhje me Hapin 4 të Metodologjisë së VN-së, duke trajtuar ndikimet ekonomike, sociale, mbi NVM-të, mbi konkurrencën dhe mjedisore.

Grupet e prekura

Grupi 1 – Institucionet publike

- AKSHI dhe struktura përgjegjëse për IA.
- Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut.
- Autoriteti Njoftues.
- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Institucionet publike që përdorin sisteme IA.

Grupi 2 – Ofruesit, zhvilluesit dhe importuesit e sistemeve IA

- Kompanitë e teknologjisë.
- Start-up-et dhe ndërmarrjet inovative.
- Ofruesit e modeleve GPAL.
- Integratorët e sistemeve IA.

Grupi 3 – Përdoruesit profesionalë të IA

- Bankat.
- Kompanitë e sigurimeve.
- Spitalet dhe institucionet shëndetësore.
- Institucionet arsimore.
- Punëdhënësit.
- Administrata publike.

Grupi 4 – Qytetarët dhe konsumatorët

- Individët që preken nga vendimmarrja automatike.
- Punëmarrësit.
- Studentët.
- Pacientët.
- Konsumatorët e shërbimeve.

Grupi 5 – NVM-të dhe start-up-et

- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që zhvillojnë ose përdorin IA.

1. Institucionet publike

Ndikime financiare dhe buxhetore

Projektligji krijon detyrime të reja institucionale për administratën publike. Kostot kryesore lidhen me krijimin dhe funksionalizimin e Strukturës së Inteligjencës Artificiale pranë AKSHI-t, forcimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut me kapacitete të reja mbikëqyrëse, krijimin e regjistrit kombëtar të sistemeve të inteligjencës artificiale me rrezik të lartë, si dhe mbështetjen administrative dhe teknike të sandbox-it rregullator dhe panelit shkencor.

Në aspektin sasior, pritet të nevojiten burime shtesë njerëzore me ekspertizë në inteligjencën artificiale, analizën e riskut, auditimin e algoritmeve dhe vlerësimin e konformitetit. Kostot fillestare do të përqendrohen në ngritjen e strukturave dhe zhvillimin e infrastrukturës teknologjike, ndërsa kostot operative do të lidhen me pagat, trajnimet, mirëmbajtjen e sistemeve dhe aktivitetet e mbikëqyrjes.

Ky opsion krijon detyrime të reja për administratën publike, të cilat sjellin nevojë për financim shtesë në fazën e zbatimit dhe operimit.

Kostot kryesore lidhen me:

- krijimin dhe funksionalizimin e Strukturës së Inteligjencës Artificiale pranë AKSHI-t;
- forcimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut me kapacitete të reja mbikëqyrëse;
- krijimin dhe administrimin e Regjistrit Kombëtar të sistemeve të IA me rrezik të lartë;
- zhvillimin dhe operimin e sandbox-it rregullator;
- mbështetjen e panelit shkencor dhe mekanizmave të vlerësimit teknik.

Kostot ndahen në:

- **kosto fillestare:** rekrutim i stafit, trajnime, zhvillim i infrastrukturës IT dhe ngritje e strukturave të reja;
- **kosto operative (të vazhdueshme):** paga, mirëmbajtje e sistemeve, trajnime të vazhdueshme dhe aktivitete mbikëqyrëse.

Nga ana tjetër, në afat të mesëm dhe afatgjatë pritet të krijohen përfitime financiare nëpërmjet reduktimit të kostove që lidhen me incidentet e mundshme nga përdorimi i pakontrolluar i sistemeve IA, përmirësimit të efikasitetit të mbikëqyrjes së tregut dhe përdorimit më të sigurt të teknologjive të avancuara në administratën publike.

Ndikime institucionale

Ndikimet kryesore përfshijnë:

- forcimin e rolit të AKSHI-t si strukturë teknike qendrore për zhvillimin dhe mbështetjen e sistemeve të IA;
- rritjen e rolit mbikëqyrës të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut;
- qartësimin dhe ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse;
- krijimin e mekanizmave të rinj të koordinimit ndërinstitucional;
- ngritjen e njësisive të reja teknike për auditimin e algoritmeve, analizën e riskut dhe vlerësimin e konformitetit.

Projektligji gjithashtu kërkon rritje të kapaciteteve njerëzore në administratë, veçanërisht në fushat e inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe analizës së të dhënave.

Ndikime sociale

Ky opsion pritet të ketë ndikim pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe rritjen e sigurisë në përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Ndikimet kryesore përfshijnë:

- rritjen e mbrojtjes ndaj diskriminimit algoritmik;
- forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrjen automatike;
- mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale;
- rritjen e besimit publik në përdorimin e teknologjive të avancuara në administratë.

Në të njëjtën kohë, mund të ketë sfida të lidhura me përshtatjen e qytetarëve dhe institucioneve ndaj proceseve të reja të digjitalizuara dhe të automatizuara.

4. Ndikime teknologjike dhe ligjore

Projektligji kontribuon në modernizimin e infrastrukturës dixhitale të administratës publike dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian.

Ndikimet përfshijnë:

- krijimin e një regjistri të centralizuar për sistemet e IA me rrezik të lartë;
- rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet sistemeve publike;
- forcimin e sigurisë kibernetike;
- përafrimin me kuadrin rregullator të BE-së për inteligjencën artificiale;
- nevojën për akte nënligjore dhe udhëzime teknike për zbatimin e ligjit.

2. Ofruesit dhe zhvilluesit e sistemeve IA

Ndikime ekonomike dhe financiare

Ky opsion krijon detyrime të reja rregullatore për subjektet private që zhvillojnë, importojnë ose ofrojnë sisteme të inteligjencës artificiale, veçanërisht për sistemet e klasifikuara me rrezik të lartë.

Kostot kryesore përfshijnë:

- kostot e dokumentimit teknik, përfshirë përgatitjen e dosjes së konformitetit dhe dokumentacionit të sistemit;
- kostot e menaxhimit të riskut, përfshirë identifikimin, vlerësimin dhe mitigimin e rreziqeve gjatë ciklit jetësor të sistemit;
- kostot e regjistrimit në regjistrin kombëtar të sistemeve IA, për sistemet me rrezik të lartë;
- kostot e auditimit dhe testimit të algoritmeve, përfshirë verifikimin e saktësisë, bias-it dhe performancës;
- kostot e vendosjes së mekanizmave të mbikëqyrjes njerëzore;
- kostot e sigurimit të cilësisë së të dhënave dhe menaxhimit të tyre.

Në terma ekonomike, këto përfaqësojnë një rritje të kostos së hyrjes në treg (market entry cost) dhe një rritje të kostos operative për zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemeve IA.

Megjithatë, në afat të mesëm pritet:

- rritje e besueshmërisë së produkteve IA;
- ulje e riskut ligjor dhe të padive;
- akses më i lehtë në tregjet e BE-së për subjektet e pajtueshme.

2. Ndikime organizative dhe strukturore

Projektligji kërkon ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si kompanitë e zhvillojnë dhe menaxhojnë sistemet e IA.

Ndikimet kryesore përfshijnë:

- krijimin e funksioneve të reja brenda kompanive, si:
 - compliance officer për IA;
 - specialist i riskut algoritmik;
 - auditues i modeleve (AI auditor);
- integrimin e procesit të “compliance by design” në ciklin e zhvillimit të produkteve;
- formalizimin e proceseve të testimit dhe verifikimit para hedhjes në treg;
- rritjen e dokumentimit të proceseve teknike dhe vendimmarrëse.

Kjo sjell kalim nga një model zhvillimi fleksibël në një model të strukturuar dhe të rregulluar.

3. Ndikime teknologjike dhe operacionale

Projektligji ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e projektimit dhe zhvillimit të sistemeve IA.

Ndikimet kryesore përfshijnë:

- nevojën për gjurmueshmëri të dhënave dhe modeleve gjatë gjithë ciklit jetësor;
- kërkesën për shpjegueshmëri të algoritmeve;
- implementimin e mekanizmave për monitorim të vazhdueshëm të performancës së sistemit;
- integrimin e kontroleve për parandalimin diskriminimit algoritmik;
- përdorimin e arkitekturave më të sigurta dhe të audituara.

Në aspektin teknik, kjo mund të rrisë kompleksitetin e zhvillimit, por njëkohësisht rrit cilësinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve.

4. Ndikime ligjore dhe rregullatore

Projektligji krijon një kuadër të detyrueshëm të përputhshmërisë për ofruesit e IA, duke sjellë:

- detyrim për konformitet para hedhjes në treg (pre-market compliance);
- detyrim për regjistrim të sistemeve me rrezik të lartë;
- përgjegjësi të qarta ligjore për dështimet e sistemeve IA;

- detyrim për bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;
- përafrim me standardet e Bashkimit Evropian për inteligjencën artificiale.

Kjo rrit sigurinë juridike, por njëkohësisht rrit edhe ekspozimin ndaj përgjegjësiwe ligjore dhe administrative.

5. Ndikime në treg dhe konkurrencë

Projektligji ka ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën e tregut të IA:

- rrit barrierat për hyrjen e aktorëve të vegjël (SME);
- favorizon kompanitë me kapacitete më të mëdha compliance;
- nxit konsolidimin e tregut;
- rrit kërkesën për shërbime të specializuara (auditim IA, certifikim, konsultim rregullator).

Në të njëjtën kohë, krijon mundësi për zhvillimin e një tregu të ri shërbimesh rregullatore dhe teknologjike.

6. Ndikime sociale indirekte

Edhe pse tërthorazi, ofruesit e IA ndikojnë në shoqëri përmes mënyrës si dizajnohen sistemet.

Ndikimet përfshijnë:

- reduktim të rrezikut të diskriminimit algoritmik;
- rritje të transparencës ndaj përdoruesve fundorë;
- rritje të besimit në shërbimet dixhitale;
- përmirësim të cilësisë së vendimmarrjes automatike.

3. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)

Ndikime ekonomike

NVM-të do të përballen me kosto fillestare të përshtatjes me kërkesat e reja ligjore. Këto kosto mund të jenë relativisht më të larta në raport me kapacitetet e tyre financiare sesa për ndërmarrjet e mëdha.

Megjithatë, projektligji parashikon mekanizma lehtësues, si dokumentacion teknik të thjeshtuar dhe akses në sandbox-et rregullatore, duke reduktuar barrën administrative dhe duke mbështetur inovacionin.

4. Qytetarët dhe konsumatorët

1. Ndikime sociale

Projektligji ka ndikim kryesisht pozitiv mbi qytetarët dhe konsumatorët, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore në përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Ndikimet kryesore përfshijnë:

- rritjen e mbrojtjes ndaj përdorimit të sistemeve të IA që mund të paraqesin rrezik të papranueshëm për të drejtat dhe liritë themelore;
- forcimin e parimit të transparencës algoritmike, duke mundësuar kuptueshmëri më të madhe mbi mënyrën e funksionimit të sistemeve automatike;

- rritjen e llogaridhënies institucionale dhe teknologjike, përmes mekanizmave të auditimit dhe mbikëqyrjes njerëzore;
- përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe reduktimin e rrezikut të keqpërdorimit të tyre;
- uljen e rrezikut të diskriminimit algoritmik në aksesin ndaj shërbimeve publike dhe private.

Në terma socialë, pritet gjithashtu:

- rritje e besimit të qytetarëve në përdorimin e teknologjive dixhitale;
- përmirësim i perceptimit të drejtësisë në vendimmarrje të automatizuara;
- rritje e sigurisë në ndërveprimin me sisteme inteligjente.

2. Ndikime ekonomike

Nga perspektiva ekonomike direkte, nuk identifikohen kosto financiare të drejtpërdrejta për qytetarët dhe konsumatorët në lidhje me zbatimin e projektligjit.

Megjithatë, ndikimet ekonomike janë kryesisht indirekte dhe afatgjata, dhe përfshijnë:

- reduktimin e kostove sociale të lidhura me vendimmarrje të padrejta ose të pasakta nga sistemet IA (p.sh. refuzime të gabuara, diskriminim në akses shërbimesh);
- rritjen e efikasitetit në përdorimin e shërbimeve publike dixhitale, duke ulur kohën dhe kostot e transaksioneve administrative;
- përmirësimin e aksesit në shërbime më të sigurta dhe më të besueshme digjitale;
- rritjen e besimit të konsumatorëve në tregjet dixhitale, gjë që mund të ketë efekt pozitiv në përdorimin e shërbimeve online dhe inovacionin.

Në afat të gjatë, këto ndikime mund të kontribuojnë në:

- rritje të mirëqenies sociale;
- ulje të kostove të mosmarrëveshjeve dhe ankesave administrative;
- përmirësim të efikasitetit të përgjithshëm të tregut dixhital.

3. Ndikime mbi të drejtat dhe sigurinë e konsumatorit (shitesë e rëndësishme RIA)

Projektligji forcon edhe dimensionin e mbrojtjes së konsumatorit në mjedisin dixhital, duke garantuar:

- të drejtën për informim mbi përdorimin e sistemeve të IA;
- të drejtën për ndërhyrje njerëzore në vendimmarrje automatike;
- të drejtën për ankim ndaj vendimeve të marra nga sistemet IA;
- rritjen e sigurisë së produkteve dhe shërbimeve të bazuara në IA.

Në tërësi, ndikimi mbi qytetarët dhe konsumatorët është pozitiv, me fokus në rritjen e mbrojtjes së të drejtave themelore, transparencës dhe sigurisë në përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale. Ndërsa nuk parashikohen kosto direkte financiare, përfitimet kryesore janë sociale dhe ekonomike në afat të mesëm dhe të gjatë, përmes rritjes së besimit dhe reduktimit të risqeve nga vendimmarrja algoritmike.

Ndikimet ekonomike (të përlllogaritura në mënyrë sasiore) – mbi buxhetin e shtetit

Kostot kryesore buxhetore lidhen me krijimin e Strukturës së IA-së pranë AKSHI-t (përfshirë personel të specializuar në vlerësimin teknik të sistemeve IA), forcimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut me kompetenca dhe ekspertizë të reja, krijimin e infrastrukturës së regjistrimit kombëtar të sistemeve IA, dhe mbështetjen administrative të panelit shkencor e sandbox-it rregullator.

Commented [FS2]: Do të plotësohet nga Drejtoret Teknik

Kosto buxhetore të vitit të parë (shumatore e shpenzimeve që do të kryhen vetëm një herë nga institucioni) (~X milionë lekë)

Commented [FS3]: Do të plotësohet nga Drejtoret Teknik

Kostoja e vitit të parë përfshin si shpenzimet fillestare të ngritjes së strukturave të reja institucionale, ashtu edhe kostot operative të fillimit të zbatimit të ligjit.

Commented [FS4]: Do të plotësohet nga Drejtoret Teknik

- **Krijimi i Strukturës së IA-së pranë AKSHI-t** – rreth X milionë lekë
 - Rekrutimi i ekspertëve të inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe vlerësimit të sistemeve IA.
 - Pajisja e stafit me infrastrukturën e nevojshme të punës.
 - Trajnime fillestare dhe ngritja e kapaciteteve profesionale.
- **Forcimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut** – rreth X milionë lekë
 - Shtim i kapaciteteve njerëzore për mbikëqyrjen e sistemeve IA.
 - Trajnime teknike dhe juridike për zbatimin e kërkesave të reja.
 - Hartimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit.
- **Krijimi i Regjistrisë Kombëtare të Sistemeve IA** – rreth Y milionë lekë
 - Projektimi dhe zhvillimi i platformës elektronike.
 - Integrimi me sistemet ekzistuese shtetërore.
 - Testimi, siguria e të dhënave dhe vendosja në funksion.
- **Mbështetja administrative e Panelit Shkencor dhe Sandbox-it Rregullator** – rreth Y milionë lekë
 - Organizimi i mbledhjeve dhe proceseve të vlerësimit.
 - Shpenzime administrative dhe logjistike.
 - Angazhimi i ekspertëve të jashtëm sipas nevojës.

Commented [FS5]: Do të plotësohet nga Drejtoret Teknik

Commented [FS6]: Do të plotësohet nga Drejtoret Teknik

Këto komponentë së bashku gjenerojnë një kosto fillestare prej afërsisht **Z milionë lekësh**, e cila lidhet kryesisht me ngritjen e kapaciteteve dhe infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e kuadrit të ri rregullator.

Kosto operative vjetore nga viti i dytë (~X milionë lekë/vit)

Commented [FS7]: Do të plotësohet nga Drejtoret Teknik

Pas përfundimit të fazës së ngritjes, kostot reduktohen dhe lidhen kryesisht me funksionimin e strukturave të krijuara:

- Pagat dhe shpenzimet e personelit të specializuar në AKSHI dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes së Tregut. (Ketu do të parashikohet struktura e vecante që do të ngrihet, për shembull, Drejtor, 2 përgjegjes sektori, 6 specialiste X pagën bruto të secilit dhe do të bëhet një shumatore për 12 muaj).
- Mirëmbajtja, përditësimi dhe administrimi i Regjistrisë Kombëtare të Sistemeve IA. (sa parashikohet kosto në mënyrë të përafërt)
- Aktivitetet e monitorimit, inspektimit dhe vlerësimit të përputhshmërisë së sistemeve IA. (te vlerësohet kosto në mënyrë të përafërt).

- Funksionimi i Panelit Shkencor dhe Sandbox-it Rregullator. (te vleresohet kosto ne menyre te perafert).
- Trajnime të vazhdueshme dhe zhvillim profesional i stafit. (te vleresohet kosto ne menyre te perafert).

Për rrjedhojë, pas investimit fillestar, kostoja vjetore (shumatore e te gjithë komponenteve te mesiperme) përlllogaritet në rreth **Y milionë lekë në vit**, duke mbuluar funksionimin e përhershëm të mekanizmave institucionalë dhe teknikë të parashikuar nga projektligji.

Commented [FS8]: Do te plotesohet nga Drejtoret Teknik

Ndikimet ekonomike mbi bizneset

Ndikimi mbi bizneset është i diferencuar sipas nivelit të rrezikut të sistemeve që operojnë: (a) bizneset që përdorin sisteme IA me rrezik minimal/të kufizuar (shumica) përballen vetëm me kosto njohëse minimale (informim mbi ligjin, eventualisht regjistrim vetëdeklarues); (b) bizneset/institucionet që ofrojnë ose përdorin sisteme IA me rrezik të lartë– një grup numerikisht shumë më i vogël, kryesisht në financa, burime njerëzore dhe infrastrukturë kritike – përballen me kosto konformiteti për sistem (dokumentacion teknik, menaxhim risku, vlerësim konformiteti).

Detyrimet kryesore për sistemet me rrezik të lartë lidhen me menaxhimin e riskut, dokumentacionin teknik, gjurmueshmërinë, mbikëqyrjen njerëzore, vlerësimin e konformitetit dhe monitorimin e vazhdueshëm të sistemit.

Ndikimi ekonomik i opsionit të preferuar mbi bizneset në Shqipëri pritet të jetë i diferencuar sipas kategorisë së sistemeve të inteligjencës artificiale që ato zhvillojnë, ofrojnë ose përdorin. Për shumicën e bizneseve, të cilat përdorin sisteme IA me rrezik minimal ose të kufizuar, ndikimet ekonomike pritet të jenë të ulëta dhe të kufizohen kryesisht në njohjen e kuadrit të ri rregullator, përditësimin e procedurave të brendshme dhe, sipas rastit, përbushjen e detyrimeve të transparencës ose regjistrimit. Këto detyrime nuk kërkojnë investime të konsiderueshme financiare dhe nuk pritet të kenë ndikim të ndjeshëm në kostot operative të biznesit.

Ndikimi kryesor ekonomik përqendrohet tek operatorët që zhvillojnë ose përdorin sisteme IA me rrezik të lartë. Në përputhje me qasjen e AI Act, këto sisteme janë kryesisht ato që përdoren në fusha si rekrutimi dhe punësimi, vlerësimi i kredive dhe shërbimeve financiare, arsimit, shëndetësia, siguria, infrastruktura kritike dhe shërbimet publike. Për këto kategori sistemesh kërkohet krijimi i mekanizmave të menaxhimit të riskut, dokumentimi i funksionimit të sistemit, ruajtja e evidencave dhe log-eve, sigurimi i mbikëqyrjes njerëzore dhe kryerja e procedurave të vlerësimit të konformitetit.⁷

Për bizneset shqiptare që aktualisht nuk operojnë në mjedise të rregulluara ose nuk zbatojnë standarde të ngjashme të kontrollit të cilësisë, këto kërkesa mund të përkthehen në nevojën për angazhimin e ekspertëve teknikë dhe juridikë, zhvillimin e procedurave të reja të brendshme, trajnimin e personelit dhe dokumentimin e proceseve të zhvillimit dhe përdorimit të sistemeve IA. Në këtë aspekt, kostoja kryesore nuk lidhet domosdoshmërisht me teknologjinë në vetvete, por me ngritjen e strukturave organizative dhe procedurale që sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

Një pjesë e rëndësishme e ndikimit ekonomik lidhet gjithashtu me ndryshimin e mënyrës së menaxhimit të sistemeve IA. Ashtu siç është vlerësuar nga Komisioni Evropian, përputhshmëria nuk konsiderohet një ushtrim i vetëm administrativ, por një proces i vazhdueshëm që kërkon monitorim, përditësim dhe rivlerësim periodik të rreziqeve gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemit. Kjo mund të sjellë rritje të kostove administrative dhe operative për bizneset që përdorin sisteme IA në procese vendimmarrëse me ndikim të lartë mbi individët.⁸

⁷ Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence - [Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence | Shaping Europe's digital future](#)

⁸ Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence - [Impact Assessment of the Regulation on Artificial intelligence | Shaping Europe's digital future](#)

Megjithatë, ndikimet ekonomike nuk janë vetëm kosto. Vendosja e kërkesave të harmonizuara me legjislacionin e Bashkimit Evropian krijon siguri juridike më të lartë për operatorët ekonomikë dhe redukton pasiguritë rregullatore lidhur me zhvillimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale. Komisioni Evropian ka vlerësuar se standardizimi dhe harmonizimi i kërkesave të përputhshmërisë kontribuon në uljen e kostove afatgjata të biznesit dhe krijon kushte më të favorshme për zhvillimin e inovacionit dhe qarkullimin e produkteve dhe shërbimeve në treg.

Në rastin e Shqipërisë, këto përfitime mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për bizneset që ofrojnë shërbime digjitale, zhvilluesit e softuerëve, kompanitë fintech, operatorët e telekomunikacionit dhe subjektet që synojnë të operojnë ose të ofrojnë shërbime në tregun e Bashkimit Evropian. Për këto subjekte, harmonizimi me standardet evropiane mund të reduktojë kostot e përshtatjes në të ardhmen dhe të lehtësojë aksesin në tregje më të mëdha ndërkombëtare.

Nga ana tjetër, nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kostoja totale që do të përballojë sektori privat në Shqipëri. Aktualisht nuk ekzistojnë të dhëna mbi numrin e bizneseve që zhvillojnë, ofrojnë ose përdorin sisteme IA, nuk ekziston një regjistër i këtyre sistemeve dhe nuk disponohen të dhëna që lejojnë klasifikimin e tyre sipas kategorive të rrezikut të parashikuara nga projektligji. Për këtë arsye, çdo përllogaritje e kostove agregate do të mbështetet në supozime të pasigurta dhe nuk do të ishte metodologjikisht e besueshme. Si rrjedhojë, analiza kufizohet në identifikimin e llojeve të kostove dhe të grupeve të bizneseve që potencialisht do të preken nga ndërhyrja rregullatore.

Testi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM)

Vlerësimi i ndikimit mbi NVM-të tregon se ky opsion përmban një sërë mekanizmesh të projektuar për të kufizuar barrën rregullatore mbi bizneset e vogla dhe të mesme, duke reflektuar qasjen e ndjekur edhe nga Bashkimi Evropian në kuadër të Aktit për Inteligjencën Artificiale (AI Act). Qëllimi i këtyre masave është të sigurojnë që detyrimet e reja të jenë proporcionale me madhësinë e operatorit ekonomik, nivelin e riskut të sistemit të përdorur dhe kapacitetet administrative e financiare të subjektit.

Së pari, projektligji parashikon mundësinë e përdorimit të formateve të thjeshtuara të dokumentacionit teknik për NVM-të dhe start-up-et. Kjo masë synon të reduktojë kostot administrative që lidhen me dokumentimin, raportimin dhe demonstrimin e përputhshmërisë, duke shmangur vendosjen e kërkesave të njëjta procedurale për operatorë me kapacitete shumë të ndryshme ekonomike dhe organizative.

Së dyti, krijimi i sandbox-it rregullator ofron një mjedis të kontrolluar ku NVM-të dhe sipërmarrjet inovative mund të zhvillojnë, testojnë dhe përmirësojnë sisteme të inteligjencës artificiale nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente. Kjo qasje synon të ulë kostot e hyrjes në treg për teknologjitë e reja, të reduktojë pasigurinë juridike dhe të shmangë situatat ku bizneset e vogla do të detyroheshin të përballonin menjëherë të gjitha kostot e përputhshmërisë para se produkti ose shërbimi të arrinte një nivel të mjaftueshëm zhvillimi.

Së treti, projektligji ngarkon autoritetet kompetente me detyrimin për të hartuar udhëzime dhe materiale praktike të posaçme për NVM-të. Kjo masë synon të reduktojë kostot e informacionit dhe kostot e interpretimit të legjislacionit, të cilat zakonisht rëndojnë më shumë mbi operatorët e vegjël sesa mbi ndërmarrjet e mëdha që disponojnë struktura të specializuara juridike dhe të pajtueshmërisë.

Gjithashtu, projektligji parashikon zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendosjen e masave administrative dhe sanksioneve, duke kërkuar që autoritetet të marrin në konsideratë madhësinë e ndërmarrjes, kapacitetin ekonomik të saj, natyrën e shkeljes dhe nivelin e riskut të krijuar. Kjo qasje synon të shmangë ndikime disproporcionale mbi operatorët më të vegjël dhe të garantojë që mekanizmat e zbatimit të ligjit të mos pengojnë inovacionin dhe zhvillimin e tregut.

Në tërësi, vlerësimi tregon se projektligji nuk krijon barrë të konsiderueshme për shumicën e NVM-ve, të cilat përdorin sisteme IA me rrezik minimal ose të kufizuar. Detyrimet kryesore dhe kostot më të larta të përputhshmërisë përqendrohen tek operatorët që zhvillojnë ose përdorin sisteme IA me rrezik të lartë,

pavarësisht madhësisë së tyre. Për rrjedhojë, ndikimi mbi NVM-të vlerësohet si i kufizuar dhe i balancuar nga masat mbështetëse të parashikuara në projektligj.

3.5 Testi i Konkurrencës

Vlerësimi i ndikimit mbi konkurrencën tregon se ky opsion nuk pritet të krijojë kufizime të pajustificuara në funksionimin e tregut dhe as të pengojë hyrjen e operatorëve të rinj ekonomikë. Përkundrazi, ai synon të krijojë një kuadër rregullator të qartë dhe të parashikueshëm për zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Projektligji nuk kufizon numrin e operatorëve që mund të hyjnë në treg dhe nuk rezervon aktivitete të caktuara për kategori specifike subjektësh. Çdo operator ekonomik mund të zhvillojë, ofrojë ose përdorë sisteme IA, me kusht që të respektojë kërkesat e aplikueshme sipas nivelit të riskut të sistemit. Për rrjedhojë, nuk krijohen monopole ligjore, kufizime sasiore apo mekanizma që favorizojnë operatorë të caktuar.

Po ashtu, kërkesat e projektligjit zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj operatorëve vendas dhe të huaj. Kriteret e përputhshmërisë lidhen me karakteristikat dhe riskun e sistemit të inteligjencës artificiale dhe jo me origjinën e operatorit ekonomik. Kjo qasje garanton neutralitet konkurrues dhe shmang krijimin e avantazheve ose disavantazheve të pajustificuara ndërmjet kategorive të ndryshme të pjesëmarrësve në treg.

Ndikimi mbi konkurrencën pritet të jetë i kufizuar edhe për shkak se shumica e sistemeve IA që përdoren aktualisht nga bizneset klasifikohen si sisteme me rrezik minimal ose të kufizuar dhe nuk i nënshtrohen kërkesave të gjera të konformitetit. Për rrjedhojë, për shumicën e operatorëve ekonomikë nuk krijohen barrierat e reja domethënëse për hyrje ose zgjerim në treg.

Për sistemet IA me rrezik të lartë, projektligji vendos detyrime shtesë të përputhshmërisë, të cilat mund të sjellin kosto administrative dhe organizative. Megjithatë, këto kërkesa aplikohen në mënyrë uniforme për të gjithë operatorët që veprojnë në të njëjtin segment të tregut dhe bazohen në nivelin e riskut të sistemit. Si rrjedhojë, ato nuk krijojnë avantazhe konkurruese selektive dhe nuk shtrembërojnë kushtet e konkurrencës ndërmjet operatorëve.

Në afat më të gjatë, vendosja e një kuadri të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian pritet të reduktojë pasigurinë juridike, të rrisë besimin e përdoruesve dhe investitorëve dhe të krijojë kushte më të favorshme për zhvillimin e tregut të inteligjencës artificiale në Shqipëri. Për këtë arsye, ndikimi neto mbi konkurrencën vlerësohet si neutral deri pozitiv.

Ndikimi mjedisor- Ky opsion nuk parashikon detyrime të drejtpërdrejta mjedisore për operatorët, por përfshin, në kuadër të kodeve të sjelljes vullnetare, inkurajimin e vlerësimit dhe minimizimit të ndikimit mjedisor të sistemeve IA (efiçenca energjetike e trajnimit dhe e funksionimit të modeleve). Ndikimi i drejtpërdrejtë mjedisor i vetë projektligjit konsiderohet neutral, ndërsa ndikimi i tërthortë (përmes nxitjes së praktikave më efiçente energjetike në zhvillimin e sistemeve IA) konsiderohet potencialisht pozitiv, por jo i monetarizueshëm.

Kufizimet e analizës dhe supozimet Ky vlerësim ndeshet me kufizime të rëndësishme në disponueshmërinë e të dhënave të njohura:

- (i) Shqipëria nuk disponon ende statistika zyrtare (INSTAT) mbi numrin e sipërmarrjeve që zhvillojnë ose përdorin sisteme IA, as të ndara sipas nivelit të rrezikut sipas terminologjisë së Aneksit III. Në mungesë të këtyre, kostot për bizneset janë vlerësuar 'për sistem' (kosto njësie), në vend që të shumëzohen me një numër total bizneshesh, deri sa të kryhet një vrojtım sektorial i posaçëm gjatë periudhës së parë të zbatimit;
- (ii) kostot e ngritjes institucionale janë vlerësuar mbi bazën e strukturave organizative të krahasueshme ekzistuese brenda AKSHI-t dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut (kosto mesatare page sipas nivelit të pozicionit në administratën publike, plus kosto shtesë page prej 18.8% sipas Modelit të Kostos Standarde të përcaktuar në Metodologji), dhe jo mbi bazën e një studimi të posaçëm fizibiliteti, i cili do të kryhet në vijim si pjesë e procesit të hartimit të akteve nënligjore;

- (iii) (iii) përfitimet jo-monetare (mbrojtja e të drejtave themelore, ulja e rrezikut të diskriminimit algoritmik, rritja e besimit të investitorëve) trajtohen në mënyrë cilësore, për rastet kur monetarizimi nuk është i mundur me besueshmëri;
- (iv) dhe (iv) çdo vlerë e paraqitur në tabelat e Shtojcës 2/a dhe 2/b duhet konsideruar si vlerësim paraprak indikativ, që do të rifinohet gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore dhe të vlerësimit pas zbatimit (post-implementation review, jo më herët se 3 vjet pas hyrjes në fuqi).

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në analizën e paraqitur më sipër, Opsioni 2 (hartimi i një ligji të ri të harmonizuar plotësisht me EU AI Act) vlerësohet si opsioni i preferuar për t'u ndjekur, për arsytet e mëposhtme:

Së pari, vetëm Opsioni 2 adreson në mënyrë të plotë të katër dimensionet e problemit të identifikuar (rreziqet ndaj të drejtave themelore, mungesa e mbikëqyrjes së sistemeve me rrezik të lartë, pasiguria juridike e operatorëve, dhe hendeku me procesin e integritet evropian). Opsioni 0 nuk adreson asnjërin, ndërsa Opsioni 1 adreson vetëm pjesërisht, dhe vetëm në mënyrë jo-detyruese, të parën prej tyre, ndërsa opsioni 3 do të mundësonte adresimin e disa prej problematikave më urgjente pa krijuar një regjim të ri tërësisht të pavarur rregullator. Megjithatë, ai nuk do të krijonte një kuadër të unifikuar për inteligjencën artificiale

Së dyti, lidhur me analizën kosto-përfitim: kostot e identifikuara të Opsionit janë kosto kryesisht institucionale njëhershë/operative, të shpërndara dhe të menaxhueshme brenda buxhetit ekzistues të AKSHI-t, me mundësi të kërkimit të asistencës teknike e financiare nga BE-ja (instrumentet IPA III) për ngritjen fillestare të kapaciteteve, siç parashikohet rëndom për reforma të lidhura me përafrimin me acquis. Përkundrazi, kostoja e mosveprimit (Opsioni 0) – edhe pse zero në terma buxhetorë direkt – përfshin kosto të fshehura por reale: rrezik në rritje për shkelje të paadrsuara të të drejtave themelore (me kosto të mundshme gjyqësore/reputacionale shumë më të larta nëse ndodh një incident i rëndësishëm), humbje konkurrueshmërie për bizneset shqiptare në tregun e BE-së, dhe kosto politike/diplomatike në procesin e integritet evropian.

Së treti, Opsioni 2 është i vetmi që përmbush parimin e proporcionalitetit në mënyrë të integruar (jo si shtesë e mëvonshme): qasja e shkallëzuar sipas rrezikut do të thotë që shumica e operatorëve ekonomikë (ata me sisteme IA me rrezik minimal) nuk do të ndiejnë praktikisht asnjë barrë të re, ndërsa burimet rregullatore përqendrohen aty ku rreziku real është më i lartë.

Së katërti, periudhat tranzitore të integruara në vetë projektligjin e bëjnë Opsionin 2 të krahasueshëm me shembullin hipotetik të dhënë në vetë Metodologjinë e VN-së (Hapi 5, shembulli i 'licencimit të pompave të ujit'), ku zgjedhja e opsionit me periudhë tranzitore (analoge me 'Opsionin 2' të atij shembulli) preferohet pikërisht sepse lejon përditësim gradual të bizneseve pa vonesë të paarsyeshme në materializimin e përfitimeve rregullatore.

Në rastin konkret, për përzgjedhjen e opsionit të preferuar gjykojmë se **Analizë me Shumë Kriteria** është më e përshtatshme sesa një analizë e plotë kosto-përfitim, pasi shumë prej përfitimeve (mbrojtja e të drejtave themelore, siguria juridike, harmonizimi me acquis, rritja e besimit në IA) nuk mund të monetizohen në mënyrë të besueshme.

Bazuar në këtë analizë janë përzgjedhur kriteret dhe ju është caktuar pesha përkatëse:

Kriteret e vlerësimit

1. Harmonizimi me acquis të BE-së dhe procesin e integritet - 4
2. Siguria juridike dhe qartësia rregullatore - 4

3. Ndikimi mbi inovacionin dhe zhvillimin e tregut - 5
4. Proporcionaliteti dhe ndikimi mbi bizneset/NVM-të - 3
5. Kosto-efektiviteti - 5

Kriteret	Pesha	Opsioni 0: Status quo	Opsioni 1: Masa jo- rregullatore / vullnetare	Opsioni 2: Ndërhyrje rregullatore e plotë (Opsioni i preferuar)	Opsioni 3: Ndërhyrje rregullatore e pjesshme
Harmonizimi me acquis të BE-së dhe procesin e integritimit	4	0 (0)	0 (0)	4 (16)	2 (8)
Siguria juridike dhe qartësia e rregullatore	4	1 (4)	1 (4)	4 (16)	2 (8)
Ndikimi mbi inovacionin dhe zhvillimin e tregut	5	1 (5)	2 (10)	5 (25)	4 (20)
Proporcionaliteti dhe ndikimi mbi bizneset/NVM-të	3	0 (0)	1 (3)	3 (9)	2 (6)
Kosto-Efektiviteti	5	1 (5)	2 (10)	5 (25)	4 (20)
Pikët		14	27	91	62

Konkluzion: Opsioni i preferuar ofron performancën më të lartë në të gjitha kriteret kyçe, duke e bërë zbatimin e ligjit për IA një masë të qëndrueshme, efikase dhe strategjikisht të rëndësishme për sigurinë dhe ekonominë e vendit.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.

Struktura institucionale e zbatimit Zbatimi efektiv i ligjit kërkon angazhimin e koordinuar të disa institucioneve, secila me role të përcaktuara qartë nga vetë projektligji:

AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), në cilësinë e 'Strukturës së IA-së' siç përkufizohet në projektligj do të jetë autoriteti kryesor koordinues teknik, përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit kombëtar të sistemeve IA, funksionimin e sandbox-it rregullator, monitorimin e ofruesve të modeleve IA me qëllim të përgjithshëm dhe lehtësimin e hartimit të kodeve të sjelljes e udhëzimeve praktike =.

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut do të kryejë mbikëqyrjen ex-post të sistemeve IA të vendosura në treg, përfshirë vlerësimin e sistemeve që paraqesin rrezik, trajtimin e mospërputhjeve formale, dhe vendosjen e sanksioneve administrative.

Autoriteti Njoftues: përgjegjës për akreditimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit ('organe të njoftuara') që do të kryejnë vlerësimet e konformitetit për sistemet IA me rrezik të lartë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale: do të vazhdojë të mbikëqyrë aspektet e përpunimit të të dhënave personale brenda sistemeve IA (në veçanti lidhur me kategoritë speciale të të dhënave dhe sistemet biometrike, në bashkëpunim dhe koordinim me autoritetet e tjera kompetente.

Gjykatat administrative: do të jenë instanca e ankimit për vendimet e autoriteteve kompetente.

Plani i zbatimit dhe masat që do të ndërmerren për zbatimin e opsionit të preferuar:

1. krijimi formal dhe dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore të Strukturës së IA-së pranë AKSHI;
2. forcimi institucional i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut me kompetenca/njësi specifike për IA;
3. miratimi nga Këshilli i Ministrave i akteve nënligjore kryesore të parashikuara (organizimi institucional, metodologjia e gjobave, sandbox-i rregullator, format i thjeshtuar i dokumentacionit teknik);
4. fillimi i fushatës së ndërgjegjësimit për operatorët ekonomikë mbi ndalimet, që hyjnë në fuqi menjëherë.
5. zhvillimi dhe testimi i platformës teknike të regjistrimit kombëtar të sistemeve IA;
6. hapja për aplikime e sandbox-it rregullator; fillimi i procesit të vetëvlerësimit dhe regjistrimit nga ofruesit/përdoruesit e sistemeve IA me rrezik të lartë;
7. trajnimi i specializuar i stafit të autoriteteve kompetente mbi vlerësimin teknik të sistemeve IA (në bashkëpunim të mundshëm me asistencë teknike ndërkombëtare).
8. përfundimi i procesit të konformitetit për sistemet IA me rrezik të lartë ekzistuese;
9. fillimi i ciklit të parë të raportimit vjetor nga autoritetet kompetente; vlerësim i ndërmjetëm i performancës institucionale.

Pas vitit 3: vlerësimi i parë gjithëpërfshirës pas zbatimit (post-implementation review).

Pengesat e mundshme të zbatimit dhe masat përkatëse:

Kapaciteti teknik i kufizuar: Vlerësimi i sistemeve IA komplekse (veçanërisht modelet e mëdha gjuhësore dhe modelet IA me qëllim të përgjithshëm me 'rrezik sistemik', neni 90) kërkon ekspertizë shumë të specializuar, aktualisht e kufizuar në tregun e punës shqiptar.

Masë: angazhimi i ekspertëve të pavarur (neni 92, pika 2), përfshirë nga 'paneli shkencor' (neni 68), dhe kërkimi i asistencës teknike nga partnerë ndërkombëtarë (BE, organizata si SIGMA, që ka mbështetur edhe vetë hartimin e Metodologjisë së VN-së).

Mungesa e të dhënave bazë (baseline): Siç u theksua në kufizimet e analizës, Shqipëria nuk ka ende një hartëzim të plotë të sistemeve IA aktualisht në përdorim.

Masë: regjistri kombëtar do të shërbejë vetë si instrumenti kryesor i krijimit të kësaj baze të dhënash gjatë vitit të parë të zbatimit, duke mundësuar përditësim të vlerësimeve fillestare të kostos/përfitimit.

Koordinimi ndërinstitucional: Me disa autoritete kompetente të përfshira (AKSHI, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Njoftues, Komisioneri për të Dhënat Personale), ekziston rrezik mbivendosjesh apo boshllëqesh kompetencash.

Masë: aktet nënligjore të parashikuara nga neni 103 duhet të përcaktojnë me saktësi ndarjen e roleve dhe mekanizmat formalë të bashkëpunimit/shkëmbimit informacioni (siç parashikohet edhe në projektligj për konfidencialitetin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve).

Ndërgjegjësimi i ulët i operatorëve ekonomikë, veçanërisht NVM-ve, mbi detyrimet e reja.

Masë: detyrimi i autoriteteve kompetente për të hartuar udhëzime praktike specifike, me vëmendje të veçantë të NVM-të, plus fushata të dedikuara informuese gjatë periudhës tranzitore.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblëdhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i vazhdueshëm do të bazohet në instrumentet e parashikuara nga vetë projektligji: regjistri kombëtar i sistemeve IA, i cili do të shërbejë si burimi kryesor i të dhënave për numrin dhe llojin e sistemeve IA aktive në Shqipëri; raportimi i incidenteve serioze nga ofruesit, që do të mundësojë identifikimin e hershëm të problematikave sistematike; dhe ankesat e qytetarëve drejtuar autoritetit të mbikëqyrjes së tregut (neni 85), si tregues i drejtpërdrejtë i perceptimit dhe i ndikimit real të ligjit mbi qytetarët.

Vlerësimi pas zbatimit (post-implementation review), do të kryhet jo më herët se 3 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit dhe do të adresojë pyetjet standarde të Metodologjisë: nëse problemi fillestar (boshllëku rregullator) është adresuar realisht; nëse objektivat SMART të përcaktuar më sipër janë arritur (p.sh. % e sistemeve me rrezik të lartë të regjistruara, numri i NVM-ve që kanë përdorur sandbox-in, numri i ankesave të trajtuara); dhe nëse kanë lindur ndikime ose pengesa të paparashikuara që kërkojnë ndryshime (lista e sistemeve me rrezik të lartë) përmes mekanizmit të parashikuar në nenin 7 të projektligjit.

Ky seksion përcakton gjithashtu treguesit specifikë sasiorë të monitorimit që do të raportohen vjetore nga AKSHI dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut:

- numri i sistemeve IA të regjistruara në regjistrin kombëtar, të ndara sipas nivelit të rrezikut;
- numri i certifikimeve të konformitetit të lëshuara për sisteme me rrezik të lartë;
- numri i ankesave të paraqitura nga qytetarët pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes së Tregut dhe përqindja e tyre e zgjidhur brenda afateve ligjore;
- numri i incidenteve serioze të raportuara nga ofruesit;
- numri i NVM-ve/start-up-eve që kanë aplikuar dhe janë pranuar në sandbox-in rregullator;
- numri dhe vlera e gjobave administrative të vendosura.

Këta tregues do të krahasohen me objektivat SMART të vendosur në Pjesën 1 dhe në seksionin 'Objektivi i politikës' të Pjesës 2, për të mundësuar vlerësimin pas zbatimit (post-implementation review) jo më herët se 3 vjet pas hyrjes në fuqi.

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë		0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për bizneset - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për buxhetin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për grupet e tjera – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet totale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	0									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	0									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1 (Kuatër vullnetar / kode sjelljeje)			
Opsioni 2 (Ligj i harmonizuar me EU AI Act - i preferuar)			

Commented [FS10]: Do te plotesohet nga Drejtoret Teknik

MINISTËR

[Emri Mbiemri]

